

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7322 E shtunë 14 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

**K**ur kam lexuar për herë të parë nga Koliqi "Tregtarin e Flamujve", më është mbushur shpirti me zemëratë. Indikuar edhe nga historia e tij personale ...

Vijon në faqen 20

Nga ARIAN GALDINI

**Pse nuk ka investime të huaja në Shqipëri**



Dje

në "Deutsche Welle"

Nga BERND RIEGERT

**K**atalonja nuk është i vetmi rajon në Europë që kërkon më shumë pavarësi. Skocia, Tirol i Jugut, Aland, Flandra e ndoshta edhe Bavaria. Lista nuk është e plotë. ...

Vijon në faqen 21

**Copëzimi në shtete të vogla nuk është zgjidhje për BE-në**



Harta e vlerës së tregut në të gjithë Tiranën

## Trefishohet taksa për pronën, ja sa do të paguajmë për çdo metër katror

Publikohen shembujt konkretë për rritjen e tarifës së banesave. Pagesa, me faturën e dritave

Nga ORNELA MANJANI

Trefishohet taksa mbi pronën. Taksimi i ri mbi pronën do të variojë nga 0.076%, 0.1% dhe 0.114% të vlerës së pronës. Një nga këto tri variante do të caktohet si taksë mbi pronën, e cila do të ...

Në faqen 7

## FLET GENCI, XHAXHAI I JURGER HOXHES: NIPI S'KA LIDHJE FARE ME NGJARJEN

# "3 MAKINA POLICIE NE VEND I LANE KRIMINELET TE IKNIN"

Reportazh në Lushnjë, qytetin e gjunjëzuar nga vrasja e dy djemve të rinj. Çfarë ndodh në zonën përballë komisariatit, flasin familjarët



(Në foto) Viktima Jurger Hoxha. Banesa e familjes Hoxha. Lokali ku ndodhi masakra



Në faqet 8-9

SEANCA MARATONË

**Miratohet me konsensus përbërja e Komisionit të Reformës Zgjedhore**

Në faqen 2

KUSH E PESOI

**Ndërtimi pa leje në Këlcyrë, shkarkime dhe përjashtime në radhët e policisë**

Në faqen 10

GJYQARJA E VRARE

**Tezja i kërkon kujdestarinë, vrasësi i Fildezit: Fëmijët të rrinë me të mitë**

Në faqen 11

PAS ELIMATOREVE

**Duka: Panuçi e kaloi "klasën", pres tirozërinë në stadium**

Në faqen 22

ÇFARË NDODHI NE PERKUJTIMORE



**Përloten Sadije dhe Elona Agolli: Je më i gjallë se të gjallët, ati im**

Në faqen 14




Rrëfëhet supermodelja: E adhuroj veten, ja si e shpenzoj kohën

## Vildane Zeneli: Pse s'më besojnë njerëzit

*Ikja e Fiori Dardhës nga spektakli, ja si është për moderatoren*

Nga PAMELA ALIAJ

Është përfolur shpesh për format e saj shumë sensuale, gjithnjë në top-formë, me një trup për t'u pasur zili. Ajo është një nga modelet që përfaqëson Shqipërinë dhe Kosovën në SHBA dhe mbarë botën. Vildane Zeneli,



në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" ka folur për jetën e saj si modele, pasionet e saj jashtë kësaj fushe kaq shumë të lakuar. Gjithashtu, Vildane ka folur edhe për fotot nudo të postuara para pak kohësh, për kritikën që mori...

Suplement

# REFORMA ZGJEDHORE DEBATET

Seanca maratonë. Bylykbashi: Të dekriminalizohen zgjedhjet

## Miratohet me konsensus përbërja e Komisionit të Reformës Zgjedhore

Majko: Krimi na zgjedh, më 25 qershor pati shitblerje

Valentina Madani

Deputetët e Kuvendit miratuan mbrëmë unanimisht përbërjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, në një seancë maratonë të nisur prej orës 08:30 të mëngjesit të djeshëm dhe që ka vijuar deri pas orës 22:00. Me 116 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit kanë votuar në unanimitet për ngritjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Bashkryetarët e këtij komisioni do të jenë socialisti Bedi Çuçi dhe demokrati Oerd Bylykbashi. Problematika e zgjedhjeve dhe trajtimi i tyre në reformimin e Kodit Elektorral ishin pjesë e debatit të djeshëm në Kuvend. Për socialistët, zgjedhjet u vlerësuan pozitivisht dhe Pandeli Majko dhe Damian Gjinknuri pohan se shitblerja e votës nuk ndikoi rezultatin. Ministri për Diasporën, Majko, teksa iu referua debatit që pati mes palëve, të cilat akuzonin njëra-tjetrën si të inkriminuara, deklaroi se është koha që gjërat të thuheshin ashtu siç janë në të vërtetë. "Po, në Shqipëri është krijuar një shtresë njerëzish që shesin votën, por duhet ndarë kjo punë, kemi marrë 200 mijë vota më pak për ndonjë arsye tjetër, apo se krimi, mafia, droga, paratë e kanabisit kanë ndikuar në këto vota. O jeni viktimë, o ka ndodhur diçka tjetër. Çfarë ka ndodhur në Shqipëri me krimin, krimi i organizuar në vend, krimi i kristalizuar nuk është as me PS, as me PD nuk i zgjedhim ne, na zgjedhin ata, kjo ndodh në disa zona të caktuara. Më ka ndodhur edhe mua, më kanë thënë të pish kafe me filanin, nuk kam pranuar, kur kanë dalë votat, kam parë gropën e kam pyetur ç'është kjo gro-pë? Është ajo kafja shëf - më kanë thënë", deklaroi z.Ma-jko. Por, demokrati Oerd Bylykbashi tha se dekriminalizimi i zgjedhjeve është rekomandim prioritar i ODIHR. "Depolitizimi i administratës zgjedhore është një rekomandim për të cilin socialistët kërkojnë të adresohet", tha z.Bylykbashi. Por, Gjinknuri deklaroi: "Depolitizimi i administratës është kërkesë e hershme e shumë



Ministri për Diasporën, Pandeli Majko

1. Blendi Çuçi	bashkryetar	(PS)
2. Oerd Bylykbashi	bashkryetar	(PD)
3. Vasili Hysi	anëtar	(PS)
4. Aiket Hyseni	anëtar	(PS)
5. Adnor Shameti	anëtar	(PS)
6. Klotilda Bushka	anëtar	(PS)
7. Ermonela Felaj	anëtar	(PS)
8. Blerina Gjylmeti	anëtar	(PS)
9. Bashkim Fino	anëtar	(PS)
10. Musa Ulqini	anëtar	(PS)
11. Enkelejd Alibeu	anëtar	(PD)
12. Gent Strazimiri	anëtar	(DI)
13. Nasip Naço	anëtar	(LSI)
14. Luan Rama	anëtar	(LSI)
15. Nard Noka	anëtar	(i pavarur)
16. Vangel Dule	anëtar	(i pavarur)
17. Dashamir Shehi	anëtar	(i pavarur)
18. Faruk Mediu	anëtar	(PS)

### ZGJEDHJET

Për socialistët, zgjedhjet u vlerësuan pozitivisht dhe Majko e Gjinknuri pohan se shitblerja e votës nuk ndikoi rezultatin. Por, demokrati Oerd Bylykbashi tha se dekriminalizimi i zgjedhjeve është rekomandim prioritar i ODIHR.



Seanca e djeshme parlamentare

### Ministri Bushati: Ministrat tuaj e firmosën

## Projektligji për pakicat, LSI: Mos e votoni

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, deklaroi nga salla e Kuvendit se projektligji për mbrojtjen e pakicave është miratuar nga ata që sot e kritikojnë. Duke iu referuar kryetarit të grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, i cili tha më herët se, "ligji për pakicat bie ndesh me interesat kombëtare", Bushati theksoi se Vasili kur ishte ministër Drejtësie e ka firmosur këtë ligj, ndërsa sot kërkon që të luajë me këtë çështje. Bushati tha: "Konventa në kuadër e Këshillit të Europës përcakton pakicën kombëtare. Zërat kritikë nuk citojnë asnjë nen të kësaj konvente, që preket



apo anashkalohet nga ky ligj. Listimi i pakicave në këtë ligj nuk do të thotë se të gjitha kanë të njëjtat karakteristika dhe të njëjtat të drejta. Përkundrazi, do të thotë që shteti, duke qenë se ka aderuar në Konventën Kuadër, nuk ka deklaruar njohje formale për asnjë prej pakicave, por

fotografon realitetin dhe praktikën e akumuluar ndër vite. Ish-ministrat që kanë qenë në kabinet kanë firmosur më parë, ndërsa sot kërkojnë që të luajmë me këtë çështje", deklaroi Bushati. Petrit Vasili nënvizoi se, "projektligji nuk ka kohërencë me traditën ligjërore të Shqipërisë dhe standardet bashkëkohore për mbrojtjen e minoriteteve". "Ky është konformizëm servil, ka deformime të mëdha. Duket si projekt politik. Projektligji duhet përpunuar më thellë që të respektojë traditën shqiptare. Është provokim mbi dimensionet e bashkëjetesës dhe stis realitet të paqena", theksoi z.Vasili.

palë zgjedhjeve dhe e reformës së fundit që e refuzon PD-ja. Jemi të qartë që ka premtime për të blerë vota, por nuk enojnë rezultatin, jo faktor përcaktues". Kurse Bylykbashi reagoi: "Keni dhënë me koncesion shitblerjeje në votës, nuk merrni nga krimi për të blerë vota, por ma zgjidhni këtë problem. Nuk kemi më kriminelët këtu". Sërish një diferencë që vjen nga një tjetër rekomandim priori-

tar i ODIHR, që siç thotë Bylykbashi, nuk ishte kaq e thjeshtë, se tashmë presioni nuk ishte më vetëm mbi administratën publike. "U kërcënuan edhe punonjësit në privat për vendin e punës", deklaroi deputeti i PD-së. Kurse ministri Gjinknuri iu shpreh: "Jeni viktimë e një strategjie të keqe. Po nuk u bëtë pjesë e sistemit dhe po nuk e bindët elektoratin, do të humbni. Njerëzve jepuni shpresë". E

ndërsa Gjinknuri i këshilloi për ndryshim strategjie, Bylykbashi apelon për diçka edhe më të madhe, që sërish e ka emrin dekriminalizim. "Ashtu si edhe para katër vjetësh, edhe sot në këtë sallë ka vend vetëm për ata që zgjidhen ose për ata që blejnë vota për tu zgjedhur. Për të dyja palët nuk ka vend. Nëse duhet të fillojë dekriminalizimi i zgjedhjeve, ashtu duhet", deklaroi z.Bylykbashi.

### PANDELI MAJKO

"Po, në Shqipëri është krijuar një shtresë njerëzish që i shesin votat, atij që i jep më shumë. Kjo nuk ka ndodhur katër muaj më parë, por edhe në zgjedhjet e mëparshme. Krimi i organizuar nuk është as me PS, as me PD. Nuk i zgjedhim ne, na zgjedhin ata. Më ka ndodhur edhe mua që më kanë thënë shko në filan vend dhe pi kafe. Refuzova. Pasi pashë gropën në vota, në një zonë tonën", deklaroi z.Majko.



Deputeti i PD-së, Ervin Saliانji

### Deputeti i PD-së nxjerr listën me emra

## Saliانji: Personat që blenë votat më 25 qershor

Deputeti i PD-së, Ervin Saliانji nga Kuvendi denoncoi me emra të gjithë ata që janë përfshirë në procesin e zgjedhjeve të mbajtura me 25 qershor. "Në më shumë se 20 qendra votimi në Korçë nuk u zhvillua procesi normal. Në disa prej tyre votimi nisi shumë me vonesë. Qytetarët e kërcënuar nuk dilnin në votime. Në Sheqeras, kryetari i PS-së, person me precedentet penale kërcënonte votuesit, Shkëlqim Nakroleci e ka emrin zotëria. Në Norman, kryetari i komisionit të PS-së, Bashkim Kreka kërcënonte votuesit nëse nuk votonin hapur. Në Maliq, Branvera Bekolli, fuste duar në kuti. Ajo kërkonte që të shikonte nëse është votuar për PS-në apo jo. Sot është drejtoreshë kjo. Në lagjet e Korçës dëshmuam se si shpërndanin para nëpër banesa: Kliton Kita, drejtor i Taksave në Bashkinë e Korçës. Në lagjen 5, Enver Shahinasi drejtor i INUK. Në lagjen 15, Andi Sula, nga zyra vendore e regjistrimit të "Pasurive të Paluajshmë". Në lagjen 6, Solien Prifti drejtor në bashki. Në lagjen 6 dhe 7, Etrika Tollkuçi drejtor i ISKSH. Në lagjen 10, Fjoralba Vukutana, drejtoreshë e Arkivës. Po në lagjen 10, Erjon Gylemeni, drejtor i Shërbimit Pyjor", - tha Saliانji. Në Kuvendi publikoi një video, ku sipas tij, kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako ka festuar zgjedhjet e 25 qershorit me një bandë kriminale.



## MINISTRAT MBLEDHJA

Mbledhja e qeverisë, ALUIZNI në varësi të Ministrisë së Drejtësisë

# Edi Rama: Brenda 4 viteve Vlora do të ketë aeroport të ri

*Prokurimet, Këshilli i Ministrave shfuqizon vendimin e korrikut*



Kryeministri Edi Rama, djënë mbledhjen e qeverisë në Vlorë

Darina Tanushi

Qeveria nisi dje serinë e mbledhjeve që do të jenë të përmuajshme në çdo qark të vendit. Në mbledhjen e zhvilluar në Vlorë u vendos dje që ALUIZNI të jetë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të shkrirjes së Ministrisë së Zhvillimit Urban. Në mbledhje u miratua gjithashtu shkarkimi dhe emërimi i 3 anëtarëve të Këshillit

të Statistikave. Në mbledhjen e djeshme të qeverisë u vendos edhe shfuqizimi i vendimit nr.482, datë 5.7.2017, të Këshillit të Ministrave. "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017", që do të thotë se të gjitha ministritë tashmë e kanë rrugën e hapur për prokurime. Kryeministri Rama, pas mbledhjes bëri me dije se një ndër vendimet ishte shpallja e qendrës historike të Kaninës, zonë e mbrojtur. Paralelisht me

këtë u mor edhe një vendim tjetër për të çuar drejt realizimit projektin e qendrës së njësive administrative Brataj, ku u aprovua edhe fondi përkatës i shpronësimeve. Kryeministri dhe ministrat patën dje një dëgjësë publike për projektbuxhetin e vitit 2018 me qytetarët e Vlorës. Teksa u ndal tek problematika e ujit të pijshëm, Rama tha se brenda vitit përfundon impianti i ujërave të zeza në Ksamil, duke shtuar se po vazhdon ky projekt në Vlorë. "Bren-

da vitit të ardhshëm do të fillojmë rindërtimin e bulevardit Vlorë-Skelë. Do të vijojmë fazën e dytë të Lungomares në krahun perëndimor, për ta shtrirë deri në pyllin e Sodës. Kemi nisur një projektim të zonës qendrore të portit, pasi duam të çelim rrugën për një port turistik. Do të ishte një nxitje e fuqishme për ekonominë, punësimin dhe turizmin në Vlorë", tha kryeministri Rama. Kreu i qeverisë tha se tashmë pritet përfundimi i projektit për aeroportin e

Vlorës. Ai u shpreh se brenda këtij 4-vjeçari synohet realizimi i këtij projekti, por theksoi se kjo mbetet në kuadër të dëshirës. Gjatë dëgjësës publike, Rama ua kaloi fjalën edhe qytetarëve që ngrinin shqetësimet e problemet e tyre. Kur fjalën e mori kryebashkiaku i Selenicës, ai i kërkoi kreut të qeverisë me shumë interes për fshatin. "Unë si kryebashkiak i Selenicës, kërktoj me shumë përqendrim të vëmendjes

tek fshati, pasi vetë bashkia jonë është e shtrirë në zonë rurale. Ti ke shkuar në Ori-kum e s'ke ardhur në Selenicë. Nga ana tjetër, ne kemi bërë investime në bujqësi, pavarësisht buxhetit të vogël. Në 140 milionë të dhëna nga qeveria, 100 milionë i kam shpenzuar për bujqësinë", u shpreh kryebashkiaku. Kreu i qeverisë e lavdëroi për punën e bërë dhe për batutë i tha: "Nesër më ke atje, do vij të të vizitoj".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Institucioni i Presidencës

Kolegji i Posacëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, shpall vendet vakante për

### 7 (SHTATE) KËSHILLTARË LIGJORË DHE 3 (TRE) KËSHILLTARË EKONOMIKË.


Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkeses nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë", Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al). KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuar nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".



Upload,  
download, aty,  
këtu, kudo.

E ardhmja  
është emocionuese.

**Ready?**



## PRESIDENTI INTERVISTA

Intervista në RTK, presidenti: Të shpenzojmë sa më pak energji për debate

# Nënshtetësia për kosovarët, Meta: Do rrezikonte pezullimin e vizave

*"Roli i shqiptarëve, mjaft pozitiv dhe konstruktiv në Evropë"*

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, deklaroi dje në një intervistë për "Radio Televizionin e Kosovës - RTK" se dhënia e nënshtetësisë për shqiptarët e Kosovës mund të ndikojë në pezullimin e vizave për shqiptarët e Shqipërisë. Presidenti sqaroi se kjo nuk varet nga dëshira e tij, por vetë Shqipëria është nën monitorim, për shkak të plotësimit të kushteve për hapjen e negociatave me BE.

**Në takim me Presidentin e Kosovës patët një kërkesë nga z.Thaçi, që qytetarët e Kosovës të pajisen me nënshtetësi shqiptare. Cila është përgjigja juaj për këtë?**

Unë kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi e vlerësoj në radhë të parë si një protestë në emër të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, ndaj kushtëzimit jo shumë të drejtë dhe racional të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës me çështjet e demarkacionit apo me çështje të tjera, kur është një fakt i njohur dhe i gjithëpranuar që Kosova i ka plotësuar të gjitha detyrimet që burojnë nga udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Madje, ka plotësuar dhe më shumë se vende të tjera, që tashmë e gëzojnë liberalizimin e vizave. Dhe jam i informuar për shumë raste, jo vetëm të pamundësisë së qytetarëve të thjeshtë të Kosovës për të lëvizur lirish në vende të caktuara të Bashkimit Evropian për arsye të shkollimit apo të problemeve shëndetësore. Por edhe të rasteve të pamundësisë dhe vështirësive për zyrtarë të institucioneve më të larta të Kosovës dhe kjo natyrisht që nuk është normale. Dhe sigurisht, në këtë problem e kemi ngritur edhe në takime që kemi pasur me drejtues, përfshirë të Bashkimit Evropian në të kaluarën, që nuk është e drejtë dhe normale që pas kaq vitesh, qytetarët e Kosovës të jenë të vetmit në Ballkanin Perëndimor që të mos i gëzojnë liberalizimin të vizave. Kur është një fakt i njohur që përpara 40 vitesh për qytetarët e Kosovës, si pjesë e ish-Jugosllavisë së atëherëshme ka qenë shumë e lehtë për të lëvizur lirish në vendet evropiane, ndërkohë që shqiptarët e Shqipërisë në atë kohë e kishin të pamundur ta ndërrojnë një gjë të tillë.

Cila është përgjigja? Padyshim që po të varej prej meje dhe thjesht për dëshirën e institucioneve të tjera të Shqipërisë, si Parlamenti dhe qeveria, kjo gjë do të ishte bërë që dje dhe jo që sot. Por duhet të kenë në konsideratë faktin që në radhë të parë kjo nuk është një zgjidhje, as afatshkurtër dhe as afatgjatë për qytetarët e Kosovës. Pra, thjesht marrja e nënshtetësisë shqiptare për të pasur mundësinë për t'u gëzuar liberalizimit të vizave në pamundësi për të kaluar këtë kushtëzim që ekziston sot nga BE për çështjen e liberalizimit të vizave për arsye. Sepse së pari, në rast se do të ishte një mundësi afatshkurtër, përsëri kjo nuk do të zgjidhte problemin e zhbllokimit të proceseve integruar evropiane dhe euroatlantike të Kosovës në një plan afatgjatë. Së dyti, kjo mund të mos ishte asnjë zgjidhje afatshkurtër për arsye të Shqipëria, e cila ka në fuqi aktualisht marrëveshjen për lëvizjen e lirë në zonën Shengen, padyshim që është nën monitorim nga vendet e zonës Shengen të Bashkimit Evropian mbi plotësimin e detyrimeve për liberalizimin e lëvizjes së lirë në zonën Shengen, të cilat kanë të bëjnë me parametrat e kontrollit të kufijve, të cilat kanë të bëjnë edhe me parametrat e sigurisë të dokumenteve të udhëtimit dhe identifikimit, me parametrat e luftës kundër krimit të organizuar, me parametrat të kërkesës së



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë një interviste për "Radio Televizionin e Kosovës - RTK"

azilkërkuessve nga Shqipëria në vendet ku shqiptarët e Shqipërisë lëvizin pa viza. Që kanë të bëjnë me mënyrën se si jepet nënshtetësia apo shtetësia shqiptare, jo vetëm ndaj shtetasve shqiptarë, siç është rasti i shqiptarëve të Kosovës apo të Maqedonisë apo kudo qoftë, por edhe shtetasve të tjerë që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe që kanë të bëjnë dhe me monitorimin që marrëveshja ka për heqjen e vizave me vendet e tjera, që mund të konsiderohen vende problematike për BE apo për vendet e zonës Shengen.

Dhe me pak fjalë, një lëvizje e pakonsultuar në këtë drejtim mund të sillte pezullimin e vizave edhe për të gjithë qytetarët e Shqipërisë. Pra, mund të mos ishte tepër produktive, pavarësisht nga qëllimi i mirë pozitiv dhe ndihmues që ka një propozim i tillë. Kështu që në këtë drejtim, në duhet të shtojmë përpjekjet tona, sikurse kemi theksuar edhe në deklaratën e përbashkët me Presidentin Thaçi për të zhbllokuar çështjen e liberalizimit të vizave, ashtu sikurse duhet të punojmë dhe në mirëkuptim dhe në mirëbesim edhe me palët e Malit të Zi, por edhe me Bashkimin Evropian për çështjen e demarkacionit.

**Duke parë zhvillimet edhe në Evropë, por edhe në të gjithë botën, cili është roli i shqiptarëve në tërë këto zhvillime?**

Unë besoj se roli i shqiptarëve në tërësi ka qenë një rol mjaft pozitiv dhe konstruktiv. Jo vetëm i Shqipërisë në rajon, i Kosovës, i shqiptarëve të Kosovës, por edhe i shqiptarëve të Maqedonisë ka qenë gjithmonë një faktor stabiliteti dhe një faktor orientues për Maqedoninë në rrugën e integritimit evropiane, euroatlantike. Shqiptarët kanë qenë faktor përcaktues për rrugën euroatlantike dhe anëtarësimin e Malit të Zi në NATO, për pavarësinë e Malit të Zi, për stabi-

litetin e Malit të Zi dhe në tërësi kudo në të gjitha hapësirat e rajonit tonë.

**Cili është vlerësimi juaj, si e shohin vendet e BE-së tani Shqipërinë dhe Kosovën? Si vende që kanë ndikim në Ballkan apo i kanë ende sytë te vendet e tjera më të fuqishme?**

Së pari, duhet të kemi në konsideratë që koha vëmendja që i kushtohet rajonit tonë është shtrënguar për arsye se sfida shumë më të mëdha e kanë detyruar Bashkimin Evropian që t'u kushtojë një vëmendje dhe energji të paparashikuar më parë këtyre shteteve. Sfidat që kanë të bëjnë që nga terrorizmi, që ka goditur disa herë në zemër të Evropës, sfida që kanë të bëjnë me emigracionin e paligjshëm, sfida të cilat kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm, me krizën ekonomike me të cilën Europa u ndesh dhe që për fat të mirë ka filluar një rikuperim i situatës ekonomike dhe financiare në vendet e Eurozonës dhe të BE-së. Por edhe sfida të tjera, të cilat janë problematike dhe kërç-nuese si ato që kanë të bëjnë me krizat që ndodhën pas pranverës arabe, çështje të tjera sikurse është kriza e marrëdhënieve të perëndimit me Korenë e Veriut e shumë të tjera, të cilat do të duhej kohë për t'i numëruar.

Kështu që në këto kushte mendoj që është tepër e rëndësishme që ne të gjithë këtu në rajon të marrim më shumë përgjegjësi dhe të realizojmë një performancë akoma më të mirë se sa deri tani, pasi duhet të bëjmë më shumë për të bindur BE-në se vendet tona do t'i arrijnë dhe do t'i respektojnë detyrimet që burojnë nga një anëtarësim i mundshëm në BE dhe nuk do të jenë një problem akoma më shumë i BE-së në të ardhmen.

**Cfarë duhet të bëjnë shqiptarët e Kosovës dhe të Shqipërisë që të jenë faktorë më të fuqishëm në Ballkan?**

Mendoj se duhet të bëjmë më shumë për forcimin e institucioneve demokratike në rritjen e kredencialëve demokratike të Shqipërisë, Kosovës dhe të vendeve kudo ku jetojnë shqiptarët. Kjo do t'u jepte edhe më shumë aleatë dhe më shumë përkrahës dhe do të rriste përkrahjen e tyre për Shqipërinë, Kosovën, për shqiptarët kudo në rajon. Sigurisht edhe arritja e atyre standardeve në shumë reformat që kanë të bëjnë me forcimin e sundimit të ligjit, të cilat jo vetëm luftojnë më shumë suksesishëm se deri tani krimin e organizuar, korrupsionin dhe burokracitë e ndryshme, por njëkohësisht edhe krijojnë një ambient shumë më të sigurt dhe të besueshëm për biznesin, për investimet vendase apo për investimet e huaja. Gjithçka ka të bëjë me rritjen e besueshmërisë sonë, besueshmëri përpara i takon demokracisë, besueshmëri përpara i takon ekonomisë, biznesit.

**Si e shihni të ardhmen e shqiptarëve dhe sa jeni optimist për një bashkëpunim të madh midis Shqipërisë dhe Kosovës?**

Ne sot ndoshta nuk jemi

të kënaqur me arritjet e Shqipërisë apo të Kosovës. Nëse mua dikush do të thoshte në vitin 2000 që Shqipëria nuk do të kishte çelur negociatat për anëtarësim me BE në vitin 2017, do të më dukej dëgja e papranueshme, se besoj që Shqipëria do të ishte anëtarësuar përpara 2017-ës në BE. Apo, unë s'mund ta mendoja kurrë në vitin '98 - '99 kur bashkë me z. Hashim Thaçi, në atë kohë drejtues i UÇK-së dhe unë isha zëvendës kryeministër për qeverinë e Shqipërisë shkonim dhe takonim vëllezërit nga Kosova në qendrat humanitare në Kukës apo në Korçë dhe që sot do të isha për vizitë zyrtare në Kosovë si President i Shqipërisë dhe z. Thaçi si President i Kosovës, sepse ka qenë një kohë kur ishte tepër e vështirë për të besuar në ato mrekulli që ndodhën, natyrisht falë një sakrificë të jashtëzakonshme të popullit të Kosovës, të shqiptarëve këtu dhe kudo në të gjithë botën. Por ja që këto gjëra kanë ndodhur dhe të gjitha këto gjëra që kanë ndodhur, që Shqipëria është anëtare e NATO-s, apo që shqiptarët e Shqipërisë lëvizin pa viza. Të gjitha këto na duket sikur i kemi pasur gjithmonë, sikur i kemi pasur edhe para 30 vitesh, para 20 vitesh. Sot kërkojmë akoma më shumë. Ndërkohë që duhet të jemi të ndërgjegjshëm që BE ndeshet me sfida të panumërta. Natyrisht, edhe SHBA-të janë partneri ynë më i rëndësishëm strategjik. Sigurisht që kërkesat tona, pretendimet tona nuk mjaftojnë për arritje edhe më cilësore apo më spektakolare. Duhet të bëjmë akoma më shumë përpjekje vetë për një të ardhme më të sigurt, më të mirë, më të ndritur për qytetarët tanë. Duhet të fitojmë më shumë nga përvoja e gabimeve tona që kemi pasur në të kaluarën që të harxhojmë sa më pak energji për debate dhe konflikte shpesh jokonstruktive dhe për çështjet më madhore të ofrojme bashkëpunim, të ofrojme konsensus e kështu ndihmojmë Shqipërinë, Kosovën, të gjithë shqiptarët në rajon dhe të gjithë rajonin që të çlirojnë më shumë energji pozitive dhe të zhvillojnë ato potenciale që kanë vendet tona dhe ka rajoni ynë për zhvillim. Forcimi i paqes, i sigurisë dhe rritja e besueshmërisë në parametrat e sigurisë dhe të paparashikueshmërisë të këtij rajoni është vendimtar.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"**  
me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOKHA

Dt 13.10.2017 ora 16:00  
Përfundon Ankandi i Parë për pasuritë:

- Pasuria "Apratament" me sip. 27 m2, Nr. pasurie 7/83+1-3, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 166 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
- Me çmim 7 840 EURO
- Pasuria "Apratament" me sip. 40 m2, Nr. pasurie 7/83+1-3/1, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 167 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
- Me çmim 11 600 EURO
- Pasuria "Apratament" me sip. 66 m2, Nr. pasurie 7/83+1-4, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 168 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
- Me çmim 18 960 EURO

Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

Harta e vlerës së tregut dhe taksa për të gjitha zonat e Tiranës

Ornela Manjani

# Trefishohet taksa mbi pronën, ja pagesa për m<sup>2</sup>

Publikohen shembuj. Taksa do të vijë me faturën e dritave

Trefishohet taksa mbi pronën. Taksimi i ri mbi pronën do të variojë nga 0.076%, 0.1% dhe 0.114% të vlerës së pronës. Një nga këto tre variante do të caktohet si taksë mbi pronën, e cila do të aplikohet mbi vlerën e tregut. Në të gjitha variantet, për një shtëpi që kushton 100 mijë euro, dhe është 100 metra katrorë do të paguhet 76 euro, 100 euro ose 114 euro në vit. Taksa do të mblihdet me faturën e energjisë elektrike dhe do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Aktualisht, për një apartament të tillë në Tiranë, paguhet 22.5 euro, por më i ulët në vlerë, pasi është në zonë periferike.

**FORMULA**

Formula për taksimin e shtëpive do të ndryshojë. Ministria e Financave ka gati draftin sipas të cilit, taksa mbi pronën do të llogaritet në bazë të çmimit të referencës, i cili caktohet nga qeveria. Taksa e banesave do të fillojë që prej 1 janarit. Taksa do të vendoset me vendim të Këshillit të Ministrave, pas shqyrtimit të draftit që do të propozojë Ministria e Financave. Tak-

**ÇMIMET E REFERENCËS DHE TAKSA PËR TË GJITHA ZONAT NË TIRANË**

■ Xhamlliku, Profarma, Rr. "Bardhyl", Rr. "Kongresi i Manastirit"	77.000 lekë/m <sup>2</sup>	87 lekë/m <sup>2</sup>
■ Porcelan, Kinostudio, Rr. "Hoxha Tasim", fshati Linzë	60.000 lekë/m <sup>2</sup>	68 lekë/m <sup>2</sup>
■ Kompleksi i Spitaleve, SHIK, Oxhaku, Allias, Tufinë	70.000 lekë/m <sup>2</sup>	79 lekë/m <sup>2</sup>
■ Rr. "Njazi Meka", Bregu i Lumit, Allias i Ri, "Myslym Keta"	60.000 lekë/m <sup>2</sup>	68 lekë/m <sup>2</sup>
■ Ish-Blloku, Libri Universitar, "Vodafon"	190.000 lekë/m <sup>2</sup>	216 lekë/m <sup>2</sup>
■ Stadiumi "Selman Stermasi", Liqeni Artificial	132.000 lekë/m <sup>2</sup>	150 lekë/m <sup>2</sup>
■ Kopshiti Botanik, Rr. "Komuna e Parisit", Liqeni Artificial	107.000 lekë/m <sup>2</sup>	121 lekë/m <sup>2</sup>
■ Hotel "Diplomat", blloku "Vasil Shanto", Selltë e vogël	82.000 lekë/m <sup>2</sup>	93 lekë/m <sup>2</sup>
■ Shkolla Teknologjike, Kombinati, Vaqarr, Selltë, Yzberisht, Sharrë	65.000 lekë/m <sup>2</sup>	74 lekë/m <sup>2</sup>
■ Gjykata e Rrethit, ish-Ekspozita	72.000 lekë/m <sup>2</sup>	82 lekë/m <sup>2</sup>
■ Bar "Piazz", Blloku gjatë rrugës "Zogu i Parë", rr. "Fortuzi" deri te "Mine Peze"	130.000 lekë/m <sup>2</sup>	148 lekë/m <sup>2</sup>
■ Stacioni i Trenit, Arkiva e Përgjithshme, Hipoteka	100.000 lekë/m <sup>2</sup>	114 lekë/m <sup>2</sup>
■ "Don Bosko", Fabrika e Këpucëve, Bregu i Lumit, Rr. "Siri Kodra"	77.000 lekë/m <sup>2</sup>	87 lekë/m <sup>2</sup>
■ PTT, Telekom, ish-Lidhja e Shkrimtarëve	145.000 lekë/m <sup>2</sup>	165 lekë/m <sup>2</sup>
■ "Myslim Shyri", Drejtoria e Policisë, Kisha Katolike	139.500 lekë/m <sup>2</sup>	158 lekë/m <sup>2</sup>
■ Ish-blloku i ambasadave, Prokuroria, "Rruga e Durrësit"	102.000 lekë/m <sup>2</sup>	116 lekë/m <sup>2</sup>
■ Ferluti, ish-uzina Tirana, Shkolla e Partisë	87.000 lekë/m <sup>2</sup>	99 lekë/m <sup>2</sup>
■ Laprakë, Drejtoria e Doganave, Bregu i Lumit, Fushë Mëzë, "Don Bosko"	70.000 lekë/m <sup>2</sup>	79 lekë/m <sup>2</sup>

sa e re do të aplikohet mbi vlerën e tregut të shtëpisë dhe do të jetë nga 76 euro deri në 114 euro për një shtë-

pi me vlerë tregu 100 mijë euro. Ndërkohë që sot paguhet nga 15 lekë deri në 30 lekë për m<sup>2</sup>.

**ÇMIMET E REFERENCËS NË TIRANË**

Çmimet e referencës për

Tiranën variojnë, nga 60 mijë lekë për m<sup>2</sup> deri në 190 mijë lekë/m<sup>2</sup>. Referuar tabelave,

çmimi fiskal për shitblerjen

e apartamenteve në zonën e ish-Bllokut ka mbetur i pandryshuar. Çmimi i apartamenteve për këtë zonë do të vazhdojë të jetë 190 mijë lekë për metër katror. Sipas tabelave, rritje të çmimit fiskal për shitblerjen e apartamenteve kanë shënuar rruga "Bardhyl", Xhamlliku, Profarma, rruga "Kongresi i Manastirit" dhe bulevardi "Zhan Dark". Qeveria ka shtrënjtur edhe çmimet e shitblerjeve të apartamenteve për "Rrugën e Durrësit". Në tabelë kjo përkon me zonën kadastrale 3/1, ku çmimi më parë ishte 75 mijë lekë për metër katror, ndërsa sot bëhet 77 mijë lekë për metër katror, me një rritje prej 2 mijë lekësh për metër katror. Çmimi i referencës për këtë zonë më parë ishte 100 mijë lekë për metër katror, ndërsa bëhet 102 mijë lekë për metër katror, pra rritet 2 mijë lekë. Ndërsa për zonën 1/1, që përshin "Ali Demin" dhe fshatin Shkozë, çmimi i referencës të tregut është ulur 300 lekë për metër katror, pasi nga 98 mijë lekë për metër katror, me udhëzimin e ri bëhet 97,700 lekë për metër katror. Ulje modeste ka shënuar edhe çmimi i tregut të apartamenteve në zonën e njohur si "9-Katëshet", prej 500 lekësh për metër katror.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

**Njoftim për shprehjen e interesit për vendet vakante të 4 këshilltarëve juridikë dhe 2 këshilltarëve ekonomikë pranë Institutit të Komisionerëve Publikë**

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, shpall vendet vakante për 4 (katër) këshilltarë ligjorë dhe 2 (dy) këshilltarë ekonomikë.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institutit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë Institutit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017 në adresën [info@ikp.al](mailto:info@ikp.al). Institucioni i Komisionerëve Publikë konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim (CV), përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kriteret e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë), pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) si dhe vetëdeklarim për kriterin e parashikuar nga gërma "e", pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë), pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) si dhe gërma "e", pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Njoftim për shprehjen e interesit për vendin vakant të 1 kancelari pranë Institutit të Komisionerëve Publikë**

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.94/2017, shpall vendin vakant për 1 (një) kancelar.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institutit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë Institutit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017 në adresën [info@ikp.al](mailto:info@ikp.al). Institucioni i Komisionerëve Publikë konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim (CV), përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, dhe vetëdeklarim që vërtetojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) të jetë shtetas shqiptar;
  - b) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuara sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligj;
  - c) ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 8 (tetë) vjet;
  - d) ndaj tij të mos të ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
  - e) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;
  - f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislatcionit, në momentin e aplikimit;
  - e) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit.
  - e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" (vetëdeklarim);

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të mësipërme.

# MASAKRA NE LUSHNJE

## INTERVISTA

Nga gjurmët e gjakut dhe lulet në vendngjarje, te familjet e viktimave që kërkojnë drejtësi

# Në Lushnje, qytetin e gjunjëzuar nga masakra ku askush nuk e 'njeh' njëri-tjetrin

Dy dekada pa shkelur në "shtëpinë të tij", Aldo Bare ndjell ende frikë

Nga Lushnja  
Trëndafile Visha

**O**ra shënon 10:00. Qyte ti i Lushnjës është i heshtur. I heshtur si varri i sapombyllur i Jurger Hoxhës dhe si varri i sapohapur i Zamir Latifit, që pret të mbyllet pas një ore. Dy të rinjve që u bënë shoshë nga plumbat në atentatin e pasdites së 11 tetorit. Por edhe si një varr stërmadh i hapur shumë vite më parë dhe nuk dihet se kur do të mbyllet... Rrugët ngjajnë të paqta dhe njerëzit të qetë. Vështrimet e tyre përthyhen, ulen poshtë sapo ndeshen me të panjohurit, ndërsa duket sikur pëshpëritin nën zë "dhe jeta vazhdon"... Por kontakti i parë është krejt i rrejshëm. Një lagje dhe nëpër rrugica, "fshihet" një makth i madh. Çuditërisht, kur pyet për X apo Y person, askush nuk të kthen përgjigje. Se askush nuk e "njeh" njëri-tjetrin.

Ndalim hapim tek lokali bar-kafe ku para tij, në një tabelë shkruhet: "Bulevardi e Palmave". Në rrugën mes lokalit (ndërtesë 3-katëshe ku duken vrimat e plumbeve) dhe tabelës janë ende të dukshme gjurmët e gjakut që u derdh në masakrën e së mërkurës. Dhe shiriti i verdhë i policisë, është ende aty. Dhe një tufë lule e tharë nga dielli, që ditët e fundit ka përvëlur shumë. Dera e lokalit është e kyçur. Mbi xham është shkruar numri 0699... Mوندohemi të shohim nga xhami përbrenda. Vëmë re banakun, karriget, tavolinat. Dhe diku përsipër në një mbajtëse, Kuranin. Librin e shenjtë, të cilin Marjux Xhepexhiu që i mbijetoi sulmit, i fshinte pluhurat përditë. Në bri të lokalit, një dyqan ku para tij janë ven-



Lokali ku ndodhi ngjarja

dosur arka me fruta-perime. Pronarin e pyesim për ngjarjen me dy të vranë dhe dy të plagosur. "Nuk di asgjë. S'kam parë asgjë. Mos pyesni kot. Unë isha në bodrum kur dëgjoja krismat. Kaq mund t'ju them. - Nuk dole


gjithë. Ka lidhje ngjarja me Aldo Bare apo me drogën? Kjo, një pyetje pa përgjigje, por që flet shumë. Askush nuk guxon ta zë në gojë ish-kapon e bandës së Lushnjës. Edhe pse kanë kaluar afro dy dekada që Aldo Bare nuk ka



Pallati ku banon familja e Zamir Latifit

jashtë për të parë pasi pushuan breshëritë e kalashnikovëve - e pyesim ne. - Nuk jam aq trim sa të marr një kokërr plumbi nga kurizoziteti", thotë prerazi i moshuari. Më pas, një përgjigje të tillë do e dëgjonim pothuajse nga të

shkelur në qytetin e tij, emri i tij tremb, tmerrësisht tremb. Duket se masakra e ka gjunjëzuar Lushnjën. Dhe ende nuk dihet nëse ngjarja mori shkas nga hakmarrja mes bandave apo lufta për kontrollin e territoreve të drogës.



tjerë të afërm. I ati i viktimës, Agroni, i cili është i sëmurë, nuk nxjerr asnjë fjalë. Thjesht nuk mundet. Ndërsa nëna e të riut qan nën zë me ngulshje, dridhet e tëra dhe thotë: "Bir o bir, bir o bir". Se aq mundet të thotë. Të gjithë janë të tronditur. Ende nuk



Vendi ku ndodhi masakra

### VENDNGJARJA

Ndalim hapim tek lokali bar-kafe ku para tij, në një tabelë shkruhet: "Bulevardi e Palmave". Në rrugën mes lokalit (ndërtesë 3-katëshe ku duken vrimat e plumbeve) dhe tabelës janë ende të dukshme gjurmët e gjakut, që u derdh në masakrën e së mërkurës. Dhe shiriti i verdhë i policisë është ende aty. Dhe një tufë lule e tharë nga dielli, që ditët e fundit ka përvëlur shumë".

### NË SHTËPINË E JURGER HOXHËS

Lëmë pas vendin e ngjarjes dhe shkojmë në banesën e 26-vjeçarit të vranë Jurger Hoxha, në lagjen "Loni Dhamo". Ngjitemi në katin e dytë. Dyert janë të hapura dhe aty ndodhen të gjithë të afërmit e tij: Vëllai, xhaxhallarët, hallat, kushërinjët. Ulur në divane janë nëna, babai, gjyshja dhe të

u besohet se Jurgeri i tyre nuk është më. "E varrosëm dje (të enjten) djalin. E vranë pa pasur asnjë faj. Dhe kriminelët enden rrugëve të lirë. Kërkojmë drejtësi. Të kapen vrasësit e djalit", thotë gjyshja e viktimës.

### NË SHTËPINË E ZAMIR LATIFIT

Dje Lushnja na ngjau si një qytet tejet i madh. Humbëm nëpër rrugët e tij. "Ku e ka

carit "lëshoi" një fjalë të vetme. "Pse gërryeni kot nëpër qytet. Punë bandash është. Ka nisur me kohë. Mos trazoni ujërat kot ju gazetarët".

Nuk shpresuam kot, këpucarit na e tregoi shtëpinë e viktimës, e cila ndodhet në një pallat të ri, në lagjen "Skënder Libohova". Hyjmë në pallat. Nuk e marrim ashensorin, pasi nuk e dimë se në cilin kat ndodhet banesa e familjes Latifi. Në katin e dytë shohim dyert e apartamentit hapur. Futemi brenda me droje. "Ejani, uluni", na thotë një grua e moshuar, ndërsa pranë saj është edhe një grua tjetër. E ngushëllojmë dhe i themi se jemi gazetarë. "Jam gjyshja nga nëna e Zamir Latifit. E vranë birin e nënës, e vranë. Ka pak që e varrosëm. Të gjithë janë në drekën e tij, ndaj në shtëpi ndodhemi vetëm në të dyja. Nuk u vranë ata që duheshin, por plumbat ia morën gabimisht jetën nipit tim", thotë e moshuara. Ndërsa, sh-ton: "Nuk është e vërtetë që nipi im është marrë me drogë. Ai ka qenë dy herë në Itali. U kthye para tri ditësh. O Zot ç'na gjeit! Ia mbylli derën vazhës sime, pasi e kishte djalë të vetëm. Ime bijë ka edhe një vajzë, por ajo është e martuar, është në shtëpinë e saj. Është e tmerrshme kjo që na ndodhi, pasi vajza ime dhe dhëndri janë të dy të papunë".

**SHPLLJE E ANKANDIT TË PARË**  
Permbarusi Gjyqësor Rok Deda me adresë Rruga Sulejman Delvina Ndërtesa 51, Hyrja 9, App. Nr. 1, prane Hotel "Diplomat" Tiranë, njofton shpalljen e ankandit të trete për aksionet e shoqërisë "ENARVI" shp vetëm 12.85% e aksioneve të vilat janë në pronësi të z. Enea Troka me çmim të shitjes në anaknd në vlerën 10.691.856 (dhjetë milion e gjashtëqindëntëdhjetë mijë e tetëqindëpesëdhjetëgjashtë) lekë Personat e interesuar për të marrë pjesë në anaknd , duhet të paguajnë 10% të vlerës në llogarinë me nr. 0000 360 171 në emër të Rok G. Deda PF ne banken Raiffeisen. **Ankandit mbyllet me dt. 16.10.2017 ne ora 16:00**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**  
Ne date **16.10.2017 ne oren 16.00** ne zyren e permbarusit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adresë ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandit per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit Aree+Truall+Shtepi Banimi" me siperfaqe totale 2000 m<sup>2</sup> nga e cila truall 500 m<sup>2</sup> nga kjo ndertese 3 kateshe me siperfaqe totale 544 m<sup>2</sup>, e regjistruar ne regjistrin hipotekor me volum 4, faqe 3, numer pasurie 34/44, ne zonen kadastrale 1934, me adresë Hasan (Kruje).Cmimi ne anaknd te trete eshte ne vleren 6,552,000 (gjashte milion e peseqind e pesedhjetë e dy mijë) lekë.

**PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ**  
Permbarusi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandit per shitjen e pasurise se paluajtshme "Apartament", me Nr.Pasurie 5230-1-8, Zona Kadastrale 0512, Vll.14, Fq.49, me siperfaqe 52.02 m<sup>2</sup>, te ndodhur ne P.Sorral 17, Pall.9781, Shk.1, Ap.8, Durrës, per shitjejen e detyrimit ne favor te kreditorit ProCredit Bank Sh.a, per shumen 1'947'880.58 (nje milion e nentëqind e dyzetë e shtate mijë e tetëqind e tetëdhjetëe pite pesedhjetë e teje) Lekë dhe 33.6 (tridhjetë e tre pike gjashtë)Euro.  
Cmimi fillësar me te cilin fillon ankandit është ne shumen 22400 (njëzetë e dy mijë e katërqind) Euro.  
Ankandit zhvillohet ne date 25.10.2017, ora 16.00 ne zyren e permbarusit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toprani, Oendra Torre Drin, K12, Nr.33, Tiranë, dhe per informacion mund te kontaktoni ne Nr.0682099471, 0684054605, email ermiringodaj@zyrapermbarimit.com.





## Masakra e Lushnjës, policia në gjurmët e atentatorit të tretë

**LUSHNJE** - Grupi hetimor që po heton vrasjen e dyfishtë të tronditi qytetin e Lushnjës dy ditë më parë po punon për të identifikuar autorin e tretë të ngjarjes. Policia ka shoqëruar disa persona, në mesin e të cilëve është edhe Julian Sula, emër i njohur për blutë, pasi ka qenë disa herë i dënuar për krime të ndryshme. Megjithatë, për momentin ndaj tij nuk ka asnjë të dhënë konkrete se mund të ketë qenë personi i tretë që mori pjesë në ekzekutimin e Jurger Hoxhës dhe Zamir Latifit, raporton TV "Klan". 30 persona të tjerë, shumica dëshmitarë okularë të ngjarjes janë pyetur në polici. Një nga këtë dëshmitarë ka njohur si autor të atentatit Laert Haxhiu dhe Orges Bilbilin, tashmë të shpallur në kërkim. Haxhiu nga Prokuroria e Lushnjës është akuzuar për vrasjen e Gerti Salës, i njohur ndryshe si "Iriqi" në vitin 2009. Prokuroria e Lushnjës këtë dosje ia delegoi Prokurorisë së Vlorës për shkak se autori ishte i mitur. Por, Gjykata e Vlorës e ka dënuar Haxhiun vetëm me 1 vit burg për akuzën e vjedhjes, pasi nuk u provua akuzat e vrasjes. Edhe në 2016-ën, ai është dënuar me 1 vit e 6 muaj burg nga Gjykata e Durrësit për shitje të lëndëve narkotike. Edhe i shpalluri tjetër në kërkim, Orges Bilbili, është i dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda me 7 vite e 4 muaj burg në mungesë. Ai ka qenë një nga personat që ka paketuar drogën, e cila do ngarkohej në avionin e Xhorxo Riforमतos, i cili u rrezua në plazhin e Divjakës. Ai u zbulua nga shenjat e gishtave, të cilat u gjeten në pakot me drogë.

Nga Lushnja  
Trëndafilë Vishva  
Enida Himaj

Policia ishte 50 m larg vendit të ngjarjes dhe nuk bëri asgjë. I la katër kriminelët të iknin. FNSH-ja rrinte para spitalit, thua se do të ruanin të vdekurit. U thashë të bënin detyrën, të ndiqnin katër autorët që më ekzekutuan nipin. U thashë ndiqni deri tek Plasmasi se aty do i kapni, por nuk lëvizën nga vendi. Jurgeri nuk është trafikant droge, ashtu siç thuhet dhe as kriminel. por i pafajshëm. Ne kërkojmë zbardhjen e ngjarjes, nuk do bëjmë vetëgjyqësi". Kështu deklaroi dje Genc Hoxha, xhaxhai i Jurger Hoxhës, i cili u ekzekutua me breshëri kallashnikovi pasditën e së mërkurës në lagjen "Loni Dharmo" të qytetit të Lushnjës, në vendin e quajtur "Ura e Përroit". Në këtë ngjarje të rëndë që tronditi opinionin publik mbeti i vrarë edhe Zamir Latifi, ndërsa u plagos 26-vjeçari Marjus Xhepexhiu dhe kallimtar i rastit, Bujar Turku, 66 vjeç. Ndërkohë, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", xhaxhai i 26-vjeçarit Jurger Hoxha pohoi se në atentat morën pjesë katër persona, tre prej të cilëve kanë zbritur nga makina dhe kanë qëlluar me kallashnikov mbi të rinjtë që ndodheshin para lokalit bar kafe. Biznesmeni dhe njëkohësisht avokati Genc Hoxha u shpreh se familja e tij është persekutuar e ngjuar nga të gjitha sistemet që nga viti 1999 e deri tani në 2017. Ai tha se ndihen të kërcënuar me jetë dhe se kërkojnë mbrojtje e siguri nga shteti.

**Dy ditë më parë nipin juaj Jurgeni humbi jetën në një atentat në qendër të qytetit. Çfarë mund të na thoni për ngjarjen, e cila ka tronditur gjithë opinionin publik?**

Nipi im e ka emrin Jurger dhe jo Jurgen. Ai ishte kthyer nga Belgjika tri javë më parë dhe jo një javë, siç kemi ju thënë mediat. Ai shkonte si turist në Belgjikë, siç mund të shkojë çdo qytetar tjetër dhe nuk është e vërtetë se është marrë me drogë. Ishte tek i afërmi i tij, djali xhaxhit, pra tek nipin tjetër i imi, i cili jeton në Belgjikë dhe është i martuar me një shtetase belge. Nuk është e vërtetë se ai është i përfshirë në trafik droge. Jurgeri ishte thjesht një kallimtar i rastit në vendin ku ndodhi ngjarja. Ishte rastësisht aty.

**Ju thoni se nipin juaj ish-**

"Familja dhe të afërmit e mi rrezikojnë jetën. Kërkojmë mbrojtje, jo vetëgjyqësi"

# "Tri makina policie rrethuan vendin e ngjarjes, i lanë 4 kriminelët të iknin"

*Genc Hoxha: Nipi ishte rastësisht në vendngjarje, s'është trafikant droge. Prindërit e tij jetojnë me pension*



Viktima, Jurger Hoxha

## 4 ATENTATORËT

Genc Hoxha dje deklaroi për "GSH" se autorët të vrasjes janë katër persona. "Nipi ishte duke e pirë kafën në këmbë, kur nga një makinë kanë zbritur tre persona të armatosur e me kallashnikovë në duar. Këta kanë qëlluar menjëherë në drejtim të vendit ku ishte nipin me djemtë e tjerë, të njohur me njëri-tjetrin. Ndërsa një person tjetër ka qenë në makinë. Pra, kanë qenë katër persona. Dhe bënë atë që bënë. Krismat e armëve u dëgjuan deri këtu tek lokali dhe shtëpia ime", tha xhaxhai i viktimit, Jurger Hoxha.

**te kallimtar i rastit, ku po shkonte Jurgeni dhe pse ishte tek lokali ku ndodhi masakra?**

Nipi po shkonte për vizitë tek motra ime, pra tek halla e tij, e cila e ka shtëpinë afro 15 metër larg vendit ku ndodhi masakra. Ai ka parë djemtë që po rrinin para lokalit dhe ka ndaluar sa për t'i përshëndetur. Janë takuar siç takoh-

en çunat këtu në Lushnje.

## Çfarë ndodhi më pas?

Ai ishte duke e pirë kafën në këmbë, kur nga një makinë kanë zbritur tre persona të armatosur e me kallashnikovë në duar. Këta kanë qëlluar menjëherë në drejtim të vendit ku ishte nipin me djemtë e tjerë, të njohur me njëri-tjetrin. Ndërsa një person tjetër ka qenë në makinë. Pra, kanë

## AKUZAT NDAJ POLICISË

"Policia nuk bëri asnjë përpjekje për të kapur kriminelët, por i la të iknin. Policia ndaloi një person që nuk kishte vënë rripin dhe nuk i ndoqi autorët, të cilët u larguan. Unë u revoltova pa masë dhe u fola policëve. U thashë mos rri këtu, por ndiqni kriminelët. Shkoni tek 'Plasmasi' se aty do i kapni. U thashë: S'keni turp, s'keni! Ndërsa Forcat e Ndërhjës së Shpejtë (FNSH) rrinin para spitalit. Thua se do ruanin të vdekurit. Dhe atyre u thashë 'mos rri kot këtu, por bëni detyrën'. Asgjë nuk bënë, asgjë. Ne nuk kemi mbrojtje nga shteti. Jo vetëm kaq, por përfshijnë dhe nipin tim në trafik droge. Jurgeri është i pafajshëm", tha xhaxhai i 26-vjeçarit të vrarë, Genc Hoxha.

qenë katër persona. Dhe bënë atë që bënë. Krismat e armëve u dëgjuan deri këtu tek lokali dhe shtëpia ime. Ne shkuam në vendngjarje, por policia nuk na la të afroheshim. Policia ishte 50 metër larg, por nuk bëri asgjë.

## Si nuk bëri asgjë?

Nuk bëri asnjë përpjekje për t'i kapur kriminelët, por i lanë të iknin. Policia ndaloi një person që nuk kishte vënë rripin dhe nuk i ndoqi autorët, të cilët u larguan. Unë u revoltova pa masë dhe u fola policëve.

## Çfarë u the?

U thashë mos rri këtu, por ndiqni kriminelët. Shkoni tek 'Plasmasi' se aty do i kapni. S'keni turp, s'keni!

## Po FNSH-ja ishte në vendngjarje?

Po. Erdhën edhe ata, por rrinin para spitalit. A thua se do të ruanin të vdekurit. Dhe atyre u thashë mos rri kot këtu, por bëni detyrën, kapini vrasësit e nipit tim'. Po asgjë nuk bënë, asgjë. Ne nuk kemi mbrojtje nga shteti. Jo vetëm kaq, por përfshijnë edhe nipin tim në trafik droge. Jurgeri është i pafajshëm. Ai nuk është as përdorues droge dhe as shitës droge. Ai kishte vetëm 1.500 lekë në xhep kur e gjetën të pajetë në vendin e ngjarjes. Prindërit e tij i kemi ndihmuar ne, pasi jetojnë vetëm me lekë e pensionin. Jurgerin dhe vëllain e tij i kemi ndihmuar gjatë gjithë kohës, pasi im vëlla, Agroni është i sëmurë. Hajdeni tek shtëpia e Jurgerit dhe shkoni se nuk ka asgjë. Ndërsa, policia thotë se merit me trafik droge. Ai nuk është as përdorues dhe as

shitës droge. Nuk ishte person me precedent.

## Ku jetojnë prindërit e Jurgerit?

Ne jetojmë të gjithë në këtë ndërtesë 4-katëshe, ku kam lokalin dhe sipër shtëpitë. E kemi ndërtuar me punë. Gjithçka e kemi me djersën e ballit, pasi jam marrë me biznes. Gjithçka që thuhet, vjen nga zilia. Ne jemi 9 fëmijë (4 vëllezër dhe 5 motra). Prindërit na kanë edukuar e arsimuar të gjithëve. Na kanë mësuar të punojmë e të ngremë gjithçka me djersën e ballit. Dhe gjithçka që kemi gritur, e kemi me djersën e ballit. Nuk kemi gjuajtur njeri me pellëmbë. Unë e urrej vjedhjen dhe krimin. Pyetini për Jurgerin në Lushnje. Le të dalë vetëm një të thotë një fjalë jo të mirë për të. Ne na kanë persekutuar të gjitha sistemet. Kemi vuajtur shumë. Na kanë ngjuar që nga viti 1999 deri tani në 2017. Policia duhet të zbardhë ngjarjen, të kapë autorët e kriminit dhe të mos merret me ne.

## Pas vrasjes së dyfishtë, a janë pyetur prindërit e Jurgerit apo ju nga policia?

Askush nuk ka ardhur këtu. Askush nuk i ka pyetur prindërit e Jurgerit. Po ju them se nuk kemi mbrojtje. Nuk kemi siguri. Jemi të rrezikuar me jetë. Kemi frikë për jetën. Ata që vranë, do të vrasin sërish.

## Cili është apeli juaj?

Të zbardhet ngjarja dhe të kapen kriminelët. Ne nuk do të bëjmë vetëgjyqësi. Kërkojmë mbrojtje nga shteti. Për këtë do i drejtohem kryeministrit Rama dhe të gjitha ambasadave.

## "NGUJIMI"

"Ne na kanë persekutuar të gjitha sistemet. Kemi vuajtur shumë. Na kanë ngjuar që nga viti 1999 deri tani në 2017-ën. Policia të kapë autorët e kriminit dhe të mos merret me ne. Të zbardhet ngjarja sa më shpejt. Ne nuk do të bëjmë vetëgjyqësi. Kërkojmë mbrojtje nga shteti. Për këtë do i drejtohem kryeministrit Rama dhe të gjitha ambasadave", tha dje xhaxhai i Jurger Hoxhës.

Drejtori i Rendit: Krimi mjedisor, përgjegjësi e strukturave të Policisë Vendore

Xhensila Kodra

**N**dërtimi pa leje në grykën e Këlcyrës mbi Vjosë ka shkakuar "tërmet" në policinë e Gjirokastër. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako firmosi për shkarkime dhe përgjashime të drejtuesve vendorë. Sipas njoftimit zyrtar të Ministrisë së Brendshme, u bë me dije se konstatimi i grumbullimit të materialeve dhe fillimit të punimeve në këtë vend për devijimin e një burimi natyror uji, është bërë në datën 5 shtator 2017 nga grupi i kontrollit të territorit të Postës së Policisë Këlcyrë. Megjithatë, ngjarja nuk është raportuar pranë strukturave përgjegjëse, nuk u kryen veprimet procedurale dhe nuk u referua çështja në prokurori. "Drejtuesit e Drejtorisë Vendore nuk kanë ushtruar përgjegjësinë ndaj strukturave në varësi për raportimet për kontrollin e territorit. Kontrolli i territorit, në të cilin përfshihet edhe ruajtja e mjedisit nga çdo lloj krimi mjedisor, është detyrë e strukturave të Policisë Vendore", thuhet në njoftim. Për këtë gjë, u shkarkuan nga detyra shefi i Komisarariatit të Policisë Përmet, kryekomisar Gazmet Shehu dhe shefi i Stacionit të Policisë Këlcyrë, nënkomisar Edmond Anxhara,

# Ndërtimi pa leje në Këlcyrë, shkarkime dhe përgjashime në radhët e policisë

## Haki Çako shkarkon shefin e Komisarariatit Përmet



Ndërtimi pa leje në Këlcyrë

ra; u përjashtua nga Policia e Shtetit inspektor Dashnor Jakupi, specialist i Policisë së Zonës; u dha 'Vërejtje me paralajmërim', për zëvendës-drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, drejtues Koço Dafa; si dhe për Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, Drejtues i Parë Lorenc Pan-

ganika. Po ashtu, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, pas veprimeve hetimore referoi materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" për punonjësit e policisë Gazmet Shehu, Edmond Anxhara dhe Dash-

nor Jakupi.

### REAGIMI

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, përmes një letre dërguar drejtuesve të Policisë së Shtetit, nën ashpër mosreagimin e strukturave përgjegjëse në kohën e konstatimit të punimeve, duke nënvizuar nevojën për kontrollin e territorit, dhe tërheq

vëmendjen e strukturave vendorë të policisë lidhur me përgjegjësinë ligjore që ato kanë për parandalimin, evidentimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të ligjit, të cilat lidhen me ndërtimin në territor, si dhe me ruajtjen e mjedisit. Ministri Xhafaj tërhoqi vëmendjen e drejtorëve të policisë së qarqeve për rikoncep-

timin e një marrëdhënieje të re në shërbim të qytetarëve dhe kërkoi nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë kryerjen e analizave të veçanta me gjithë strukturat vendorë për reflektimet e duhura. Ndërkaq, Drejtori i Rendit Albert Dervishaj, në një deklaratë për mediat tha dje se "Kontrolli i territorit, në të cilin përfshihet edhe ruajtja e mjedisit nga çdo lloj krimi mjedisor, është detyrë e strukturave të Policisë Vendore. E masat e ashpra justifikojnë përmasën e problematikës së shfaqur me ndërtimin në zonën e Këlcyrës". "Në zbatim të porositve të kryeministrit dhe ministrit të Brendshëm, në të gjitha drejtoritë vendorë të policisë, do të nisim analiza të detajuara mbi problematikat e shfaqura dhe marrjen e masave për reflektimin ndaj tyre", - tha ai më tej.

### EDI RAMA

Pas shkarkimit të punonjësve të policisë, kryeministri Edi Rama reagoi në faqen e tij në rrjetin social "Facebook". "Shkarkimet në polici për krimin mbi Vjosë duhet të jenë vetëm fillimi dhe duhet të bëhen normë për çdo krim mjedisor. #PoliciqëDuaam", shkruan Rama.

### MASAT

- U shkarkua nga detyra shefi i Komisarariatit të Policisë Përmet, Kryekomisar Gazmet Shehu;
- U shkarkua nga detyra shefi i Stacionit të Policisë Këlcyrë, nënkomisar Edmond Anxhara;
- U përjashtua nga Policia e Shtetit inspektor Dashnor Jakupi, specialist i Policisë së Zonës;
- U dha 'Vërejtje me paralajmërim', për zëvendës-drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, drejtues Koço Dafa;
- U dha 'Vërejtje', për Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, Drejtues i Parë Lorenc Paganika.



### INVITATION TO TENDER

#### REHABILITATION of Health Center in Fier

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate the Health Center in Patos, in the Municipality of Fier. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works. The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/drive/folders/0B4R3lo0APolbSVNURIF5aGZlDUU>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by **sending an email to info@hap.org.al until 16<sup>th</sup> October 2017.**

The interested Companies must participate in the site visit to take place within **October 2017**. The details of **place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17<sup>th</sup> October 2017.**


The bidding Companies should submit their offers to **HAP Centre no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017.**

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF PATOS IN FIER REGION**  
 Procurement Team  
 HAP Centre  
 Rruga "Themistokil Germej", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania  
 E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); Website: [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



### INVITATION TO TENDER

#### REHABILITATION OF Health Center in Roskovec

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate 3 Health Centers in Kurjan, Strum and Roskovec in the Municipality of Roskovec, in Fier Region. In the context of this initiative HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/open?id=0B4R3lo0APolbEc2T0tu51RqVm8>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by **sending an email to info@hap.org.al until 16<sup>th</sup> October 2017.**

The interested Companies must participate in the site visit to take place within **October 2017**. The details of **place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17<sup>th</sup> October 2017.**


The bidding Companies should submit their offers to **HAP Centre no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017.**

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF KURJAN, STRUME, ROSKOVEC IN FIER REGION**  
 Procurement Team  
 HAP Centre  
 Rruga "Themistokil Germej", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania  
 E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); Website: [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

**GJERMANI** - Një 40-vjeçar shqiptar ka dalë dje para bankës së të akuzuarve në Gjykatën e Landit në Dyseldorf, nën akuzën se ka hedhur nga dritarja e katit të dytë të banesës, të dashurën e tij 24 vjeçe. Mediat gjermane shprehën se shqiptari Ardi T., ka qenë partner i gruas, e cila para një viti u rrëzua nga lartësia prej 7 metrash (kati i dytë) në një shtëpi në Dyseldorf. Mësohet se 24-vjeçarja rumune pas oper-



**40-vjeçari gjatë seancës gjyqësore: Ajo më vodhi 1.800 euro**

**Hodhi nga dritarja të dashurën, shqiptari: Nuk e shtyva unë**

acionit u ka deklaruar mjekëve se ka qenë partneri i saj ai që e ka shtyrë. Sipas organit të akuzës, Ardi T. e ka shtyrë me qëllim viktimën dhe ajo ka rënë, duke pësuar lëndime të rënda dhe paralizë. Prokurori, duke arsyetuar akuzën ka thënë se gruan e rrëzuar do ta sho-

qërojë gjatë gjithë jetës paraliza e shkaktuar nga rrëzimi.

Ai ka kërkuar dënimin me 11 vjet e gjysmë burg, duke e akuzuar 40-vjeçarin për "Goditje për vdekje" dhe për "Tregti me drogë". Kjo pasi gjatë kontrollit të banesës së të pandehurit

policët kanë gjetur drogë. Ndërkaq, prokurori ka hequr dorë nga akuzat për "Tentim vrasjeje të rëndë. Mësohet se shqiptari dhe avokati i tij mbrojtës ngulin këmbë se partnerja ka rënë vetë dhe ai nuk e ka shtyrë. Madje, sipas të pandehurit, ai ka qenë në oborr kur e ka parë

gruan të rrëzuar. Më tej ai thotë se ajo ka qenë në varësi të lëndëve narkotike dhe se i ka vjedhur atij një shumë prej 1.800 eurosh; pastaj, në përpjekje për t'u fshehur, është rrëzuar aksidentalisht. Mediat e huaja i kanë kushtuar shumë hapësirë këtij procesi gjyqësor, madje gjyqtari, për të ilustruar rrëzimin e viktimës nga dritarja, ka improvizuar një skenë të ndërtuar me biloet e njohura për lodra fëmijësh "lego".

Avokati: Fadil Kasemi mund të sigurojë të ardhura të mira financiare për rritjen dhe edukimin

**Vrasësi i Fildeze Hafizit: Fëmijët të rriten me familjarët e mi**

**Tezja e të miturve, kërkesë gjykatës për kujdestarinë e tyre**

Ina Allkanjari

Fëmijët s'kanë pse shkojnë te tezja, kur kam edhe unë motra e vëllezër sa të duash", është shprehur dje në gjykatë Fadil Kasemi, në një përballje me motrën e Fildeze Hafizit për kujdestarinë e dy fëmijëve. Amela Hafizi Asllanaj, motra e gjyqtarës së vranë në 31 gusht nga ish-bashkëshorti, ka depozituar në Gjykatën Civile të Tiranës një javë pas ngjarjes, një kërkesë për kujdestarinë e fëmijëve të së ndërjes. Në seancën e cila u mbajt dje me dyer të mbyllura, është thirrur për t'u njohur me kërkesën babai biologjik i vajzës dhe djalit të mitur: Fadil Kasemi, i cili akuzohet për vrasjen e nënës së tyre. Mësohet se ai ka refuzuar që fëmijët t'i dorëzohen tezes së tyre, duke kërkuar që kujdestarinë ta marrin të afërmit e tij. Avokati mbrojtës i Fadil Kasemit, Ndue Pjetra, ka shpjeguar se klienti i tij mund t'u sigurojë të miturve banesë dhe të ardhura të mjaftueshme



Viktima Fildeze Hafizi me dy fëmijët



Fadil Kasemi në gjykatë

financiare për rritjen dhe edukimin e tyre. Pavarësisht kësaj deklarate, seanca e së premtes u zhvillua për të vënë në dijeni babain e fëmijëve si palë e tretë e interesuar në këtë proces, mbi kërkesën e Armela Asllanajt për të marrë kujdestarinë e fëmijëve. Pasi mori pretendimet e palëve të interesuara në këtë proces, gjykata e ka shtyrë seancën për një tjetër datë, ku pala kërkuese do të paraqesë dokumentacion për të provuar sasinë e të ardhurave financiare.

**VRASJA E GJYQTARES HAFIZI**  
Më datë 31.08.2017, rreth

orës 13:50, në rrugën "Xhanfize Keko", Tiranë, shtetasja Fildeze Hafizi ka dalë nga parukearia dhe është futur brenda në automjetin e saj të parkuar aty pranë. Në atë kohë është afruar ish-bashkëshorti i saj, shtetasi Fadil Kasemi me një pistoletë në dorë dhe ka qëlluar me armë në drejtim të gjyqtarës Hafizi, duke e lënë të vdekur në vend. Më pas 53-vjeçari me pistoletën në dorë i ka dalë përpara një automjeti të rastit që po udhëtonte në drejtim të "Rrugës Bardhyl", të cilit i ka thënë se kishte vranë bashkëshorten e tij dhe nën kërcënimet e armës i ka

kërkuar atij që ta largonte nga vendi i ngjarjes duke hequr brenda në automjetin. Gjatë udhëtimit, shoferi i automjetit ka përshkuar rrugën që të dërgonte pranë Komisarariatit të Policisë Nr.1 Tiranë. Në kohën që është afruar komisarariatit, shtetasi K.T. e ka futur menjëherë automjetin e tij brenda në ambientet e Komisarariatit të Policisë. Në atë moment janë afruar menjëherë punonjësit e policisë, të cilët kanë ndërhyrë dhe kanë bërë kapjen në flagrancë të shtetasit Fadil Kasemi, duke i hequr armën pistoletë që mbante në duar.

**SHKURT**

**Prostitucion në Durrës, në pranga 2 tutoret**

**DURRËS** - Dy gra janë vënë në pranga nën akuzën "Shfrytëzim prostitucioni" nga policia e Durrësit. 57-vjeçarja S.S. dhe 49-vjeçarja T.T. u arrestuan si pjesë e finalizimit të një operacioni ditën e djeshme, pas një pune hetimore 2-mujore. Të dyja gratë janë kapur në ambientin ku ushtronin prostitucion brenda qytetit të Durrësit. Në ngarkim të shtetaseve të mësipërme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg".

**Kapet banda e drogës në Angli, mes tyre edhe shqiptarë**

**ANGLI** - Të paktën 10 persona janë arrestuar nga policia në Gloucestershire të Anglisë, mes tyre edhe shqiptarë. Gjatë operacionit të zhvilluar në Gloucestershire, policia sekuestroi një sasi droge që kap vlerën e 750 mijë paundëve. Oficerët bastisën 11 prona në Gloucester dhe Cheltenham si dhe 4 lavazhe brenda dy ditëve. Sipas "BBC", policia e Gloucestershire tha se fermat e kanabisit u zbuluan në 6 prona në Gloucester dhe Cheltenham dhe disa nga anëtarët e bandës ishin shqiptarë.

**Grabitën argjendarinë në Maltë, në pranga 2 shqiptarë**

**MALTË** - Policia e Maltës ka arrestuar dy shqiptarë, të cilët dyshohet se janë autorë të grabitjes së një argjendarie në Sliema javën e kaluar. Sipas mediave të huaja, njëri nga shqiptarët e arrestuar është Ramazan Hysa, 24 vjeç, ndërsa tjetri është rreth 26 vjeç, por identiteti i tij nuk bëhet i ditur. Pas grabitjes, shqiptarët janë larguar me bizhu me vlerë dhjetëra mijëra euro. Oficerët u vunë në ndjekje të dy të dyshuarve, ku edhe i arrestuan. Kur oficerët u afruan, njëri nga shqiptarët drejtoi armën mbi ta, por nuk arriti të qëllonte.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje dhe implementim pajisje sigurie "Advanced Network Security Threat Prevention", për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 5,000,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje dhe implementim pajisje sigurie "Advanced Network Security Threat Prevention", për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **7 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit një vjeçar të produkteve Checkpoint"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,800,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit një vjeçar të produkteve Checkpoint"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **8 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

4 kategoritë pjesëmarrëse në garë, 2500 vrapues nga 40 vende të botës

# Maratona e Tiranës, bashkia plan masash për mbarëvajtjen

## Veliaj: Rrugët ku do të ndalohet qarkullimi

Voltiza Duro

Ditën e diel, në kryeqytet do të mbahet Maratona e Tiranës, e cila do të mirëpresë rreth 2500 vrapues nga 40 vende të ndryshme të botës. Kryebashkiaku, Erion Veliaj në takim me organizatorët e kësaj ngjarjeje, diskutoi mbi detajet e fundit për mbarëvajtjen e maratonës, ku deklaroi se e diela do të jetë një festë sportive dhe që do t'i japë një impuls pozitiv edhe ekonomisë së qytetit. "Këto dy ditë janë vendimtare për mënyrën se si do të performojë qyteti për maratonën. Është hera e parë që maratona është e certifikuar ndërkombëtarisht, pra edhe do monitorohemi në këtë aspekt, megjithatë besoj se do të jetë



një festë e madhe për të gjithë Tiranën. Ne presim si vrapues profesionistë rreth 2500 atletë nga 40 vende të ndryshme të botës", tha Veliaj. Sipas tij, maratona është një mundësi shumë e mirë për promovimin e qytetit dhe ekonominë e tij. Kryebashkiaku bëri me dije se, ndryshe nga një vit më parë, maratona do të jetë kre-

jtësisht urbane, ku do të përkrahë rrugët kryesore të qytetit. "Tani kemi atë që quhet 'city marathon', pra një maratonë e fokusuar te qyteti. Kjo do të thotë që do të jetë aksi i bulevardit 'Dëshmorët e Kombit', 'Zogu i Parë', i gjithë rreth rrotullimi i Unazës së Vogël me një hyrje në Bllok në rrugën 'Ibrahim Rug-

ova', pastaj pranë Gardës, për t'u rikthyer sërish te sheshi 'Nënë Tereza', që janë fillimi dhe fundi i maratonës, pak a shumë akset që do përshkohet", tha Veliaj. Sipas tij, për vrapuesit profesionistë do përdoret edhe aksi i rrugës së 'Kavajës' deri te Kisha Ortodokse, sepse gara është kalkuluar që të ketë 3 xhiro nga 7 për profesionistët dhe 2 xhiro nga 5 për të tjerët. Kategoritë pjesëmarrëse në këtë garë do të jenë Fun Run, We too, Half Marathon dhe Tirana 10K. Kryebashkiaku theksoi se gara e parë do të jetë krosi i të rinjve, ndërkohe që do të ketë disa gara të tjera për persona me aftësi të kufizuara. Pas këtyre 2 garave, do të nisën ata që janë profesionistë, që është gara e 21 km, dhe pastaj gara e 10 km. Veliaj kërkoi mirëkuptimin e banorëve për vështirësitë që mund të ketë

**KUFIZIMI I QARKULLIMIT (DHE I PARKIMIT) TË AUTOMJETEVE**

- Ndalohet qarkullimi në sheshin "Nënë Tereza"
- Ndalohet qarkullimi në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Rr. "Lek Dukagjini"
- Ndalohet qarkullimi në segmentet rrugore "Ibrahim Rugova", "Rruga e Kavajës", deri te rrethrotullimi përballë "Kishës Ortodokse", "Ded Gjo Luli", bulevardi "Zogu I", "Urani Pano", "Rruga e Barrikadave", "George W Bush", "Abdi Toptani" dhe bulevardi "Dëshmorët e Kombit" në datën 15 tetor 2017, nga ora 05:00 deri në orën 14:00.
- Qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit do të bëhet në rrugët "Ibrahim Rugova", "Papa Gjon Pali II" dhe në bulevardin "Dëshmorët e Kombit".
- Qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit do të bëhet në rrugët "Unaza e Mesme", përveç segmentit ura e "Drejtorisë së Policisë" deri te "Rruga e Elbasanit", "Sami Frashëri", "Papa Gjon Pali II" dhe "George W Bush" deri te "Murat Toptani", "Vaso Pasha", "Myslym Shyri" deri te "Sami Frashëri", "Hoxha Tahsin" deri te sheshi "Avni Rustemi".

**ITINERARI I LËVIZJES SË MJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK DO TË DEVIJOJË SI MË POSHTË:**

- "Rruga e Elbasanit" do të devijohet tek "Ura e Lanës".
- Rruga "Hoxha Tahsin" do të devijohet te sheshi "Avni Rustemi".
- "Rruga e Dibrës" do të devijohet te "Medreseja".
- "Rruga e Kavajës" do të devijohet te "21 Dhjetori".
- Bulevardi "Zhan D'Ark" dhe bulevardi "Bajram Curri" do të devijohen tek ura e Drejtorisë së Policisë dhe tek ura e "Rrugës së Elbasanit".

me lëvizshmërinë dhe trafikun në ditët e maratonës si dhe bëri me dije se, duke filluar nga dje, një pjesë e rrugëve do t'i nënshtrohen regjimit të ndalimit të qarkullimit dhe për një numër më të vogël edhe ndalimi i parkimit. "Besoj që ora e zbrazjes së rrugëve fillon sot në mesnatë dhe do të vazhdojë deri në orën 2 ditën e diel. Në orën 2 ditën e diel, i rikthehem qarkullimit normal", deklaroi dje gjatë takimit, Kryetari i Bashkisë. Sipas tij, këto ditë do të ketë një sh-

tim të numrit të aktiviteteve argëtuese e kulturore, dhe u bëri thirrje qytetarëve që të mbështesin sportistët. Gjithashtu, Veliaj u shpreh mirënjohës për vullnetarët që ndihmuan në përgatitjen e maratonës së të dielës. "Ne kemi për herë të parë 660 vullnetarë, të gjithë që dinë ose anglisht, italisht, gjermanisht apo spanjisht e frëngjisht, pra të kenë mundësi që të komunikojnë me sa më shumë prej turistëve dhe atyre që vizitojnë Tiranën në ditët e maratonës", tha kryebashkiaku.



www.macedonia-timeless.com

# Kodra e Diellit



## Ski në Dëborë

Skijimi në Maqedoni është sport popullor që është i preferuar nga njerëzit lokal si dhe turistë të huaj. Maqedonia ofron kushtet të mira klimatike për sportin. Skijimet alpine dhe pordike janë ngjarje të mëdha që mbahen për të nxitur bukurinë e maleve të Maqedonisë. Ka dy ngjarje tradicionale që organizohen nga punëtorët e skive maqedonase: Turneu memorial i Mavrovs dhe Turneu ndërkombëtar i Skijimit Alpin i njohur edhe si Kupa e Malit Sharr që janë dy ngjarje sportive të njohura në Maqedoni të cilat janë të organizuara nga Komuniteti Bistra dhe Popova Shapka. Sportelet e konvikteve të Skijimit në dëborë janë shumë të popullizuara në Maqedoni. Ju mund të bëni ski në disa vende si: Mavrovo, Mali Sharr, Kozhuf, Peilster dhe Krusheve.



# Sipas këndvështrimit tënd

E ardhmja  
është emocionuese.

**Ready?**

 **vodafone**

AKTIVITETI PËRKUJTIMOR

Fatmira Nikolli

# Përloten Sadije dhe Elona Agolli: Je më i gjallë se të gjallët, ati im

Kalova një natë pa gjumë. Mendoja e kujtoja çaste të së shkuarës, në të cilën kujtesa me zor përpiqej lehtësisht të trokiste, por nxitja e orëve të pagjuma ishin këta dy libra. Ia dola mbanë! Përmbusha një dëshirë e lumturim. Tamam një vit më parë, babi më puthte në ballë i lumturuar duke ledhatuar kopertinën e "Prit edhe pak". Dje, kur librat e rinj i mora në dorë, syri u lagështua, prekja u zbut, vështrimi u përqendrua i palëvizur. Siç shihet e nanuritet në fëmijë, ashtu ngaherë u jemi afruar krijesave-libra. Më i gjallë se të gjallët je, babushi im..." ka qenë ky mesazhi prekës i vajzës së Dritëro Agollit në ditëlindjen e parë pa praninë fizike të tij. Gjatë një ceremonie të mbajtur pranë Muzeut Historik Kombëtar, bashkëshortja Sadije dhe e bija Elona janë përlotur. Në fjalën e mirëseardhjes, e bija Elona Agolli iu drejtua të atit: "S'e dija, babai im, se do të mblidheje kaq shumë miq. Unë përlote-sha kur më recitoje Naimin. Ai është i gjallë edhe tani. Je më i gjallë se të gjallët, ati im Dritëro. Shaban Sinani na ka ndihmuar e ka kuptuar trishtimin tim dhe të nënës sime Sadije. Më 14 shtator, nëna ime kishte 75-vjetorin e nënës dhe menduam t'i bëjmë dhuratë vargjet e tij, dhuratën e madhe që i ka lënë".



Në foto: Sadije dhe Elona Agolli në aktivitetin përkujtimor

*"Dritëroi është mes nesh këtë ditë. Ai ka vetëm datëlindje"*

Kujtoi se i thanë 'mos boto dy vepra njëherësh se marrin vëmendje'. "Nuk ka sesi të jetë ndryshe, poeti i kombit të ketë vetëm datëlindjeje. Atdheu heq kapelën para tij", - tha e bija. Elona Agolli ka bërë gati dhe ka botuar dy libra të rinj, me materiale nga shënimet e Dritëroit. Librat e rinj të botuar në ditën e lindjes së Dritëro

Agollit titullohen "E bukura, lozonjarja, tokësorja grua" dhe një libër me aforizma. Për shkrimtarin e madh, pasditen e së premtes u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar edhe një aktivitet përkujtimor me moton "Dritëroi është mes nesh këtë ditë. Ai ka vetëm datëlindje".



Në foto: Kopertinat e botimeve të reja të Dritëroit

dhe "Shkëlqimi e rënia e shokut Zyllo". "Moralistët ndoshta nuk do të ndihen në paqe me veten duke lexuar këtë libër të mbushur me njerëz me cene, çudira e marrëzira, si gjithë letërsia e tij; por kësaj here, të mbushur plot dhe me dyshimtarë të mëdhenj, që guxojnë të shohin dhe 'The dark side of the moon- Anën e errët të hënës', po të citonim një titull këngë të Pink Floyd", - shkruan në parathënie Shaban Sinani, ndërsa mbrëmë shtoi se librin e ka lënë gati autori me ndihmën e Sadijes.

Poeti Ilirian Zhupa, studiues dhe redaktor i "E bukura, lozonjarja, tokësorja grua", shënon në libër se poezitë e librit kanë mbijetuar shekulli dashuri. "Në to, si në një shirit sizmografik, dallohen qartë të gjitha trandjet dhe përjetimet e heroit lirik".

Justina Aliaj recitoi poezi dhe u kënduan këngë me tekste të Dritëroit, si "Dashuri e vështirë", "Turkesha", "Udhëtoj i menduar" apo "Poçari", ndërsa Ardit Gjebra këndoi në sallë këngën "Kur të jesh mërziur shumë". "Poeti quhet bir i harmonisë. Poeti ua 'shet' shpirtin fjalëve. Dhe me këtë i jep shpirt materies së fjalëve. I bën fjalët të dalin nga lëvizhjet apo guaskat e tyre, i bën të ikën nga pronat e tyre nominale. Lajthia hidhet në tokë bashkë me guaskën. Në tokë lajthia mbin dhe del nga guaska. Edhe poeti këtë fjalë me guaskë e bën të mbijetë duke e zhvoshkur nga guaska", thoshte Agolli në një intervistë në maj të 1995-ës.

Dritëro Agolli lindi më 13 tetor 1931, në fshatin Mengulas të Devollit, në Korçë. Shkrimtari ndërroi jetë në 3 shkurtin e këtij viti nga një sëmundje e rëndë në mushkëri. Ditëlindja e shkrimtarit të madh këtë vit nuk do të jetë e lehtë të konceptohet me mungesën e tij. Ndaj familjarët, miqtë dhe adhuruesit e shkrimtarit kanë përgatitur surpriza pa fund për këtë ditëlindje.

**HAP**  
Health for all project

**Call for: Engineering Company to provide supervisory works for the rehabilitation of four Health Centres in Fier region**

**Health for All Project in Albania (HAP)** is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by Health for All Centre in Fier and Diber regions. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

To improve conditions for health workers and users in four Health Centres in Fier, HAP Centre will contract an engineering company, here in called **The Contractor**, to do the rehabilitation in those Centres. To supervise the **Contractor's** works, HAP Centre will contract an engineer Company, herein called **The Provider**, to supervise the rehabilitation works as described in the TOR in the below link:

<https://drive.google.com/file/d/0B4R31o0APoIbNGtQRmVfN0t6Tms/view>

**The offer should include:**

1. A financial offer specifying only the supervisor-day fee and transportation cost;
2. CV of the bidder, CV of the Directors of the Company and its technical team, with details of their field of engineering, and detailed description of previous works similar to the ones expected under this TOR;
3. Names of three references of similar works, from which HAP can get information on the qualification of the bidder;
4. Licenses and registrations proving that the bidder is duly accredited and certified for carrying out the works described in the TOR

Those submitting an application should be aware that, if selected and contracted, they will be required to issue invoices (VAT or A4).

**Deadline for application**

The offers must be delivered by **25 October 2017** in sealed envelopes and with clearly marked "Public Invitation to Tender for Engineering Company" to:

Procurement Team  
HAP Centre  
Rruga "Themistokli Germenji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania  
E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)

\*Please note that the shortlisted applications will be contacted within 08 November 2017.

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

United Nations Development Programme

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.  
Job ID: 12394

<b>Post Title:</b>	Project Assistant
<b>Duty station:</b>	Tirana, Albania
<b>Duration of Assignment:</b>	1 year with possibility of extension
<b>Type of Contract:</b>	Service Contract (SC)
<b>Educational Background:</b>	University degree (Bachelor's level) in social sciences, law, economics, public policy or development related discipline
<b>Work Experience:</b>	2 years of relevant administrative or programme experience is required; Demonstrated experience and ability in building and maintaining partnerships and working relationships with civil society and other stakeholders, including government and local government officials, civic leaders, media, business people and international donors is required; Demonstrated capacity to undertake assigned responsibilities and work under pressure; Experience with advocacy on rights, especially on R/E and disability rights issues at the national level, including high-level events, an asset; Familiarity with donor priorities on social inclusion, including disability issues and experience with developing partnership offers, an asset; Experience in working with persons with disabilities, familiarity with the key issues confronting persons with disabilities, an asset; Communication and report-writing skills in English;
<b>Language Requirements:</b>	Full working knowledge of English and Albanian is essential
<b>Deadline for Application:</b>	17/10/2017
<b>Job Description:</b>	Available at UNDP site: <a href="http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/">http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/</a>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 580

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE Redaktore: Enida HIMAJ - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 14 Tetor 2017

## VILDANE ZENELI:

**JA PSE NJEREZIT S'ME  
BESOJNE QE NUK KAM BERE  
OPERACIONE PLASTIKE**



*Rrëfëhet supermodelja: Përse nuk postoj foto në rrjetet sociale si më parë. "Nuk ka nevojë të përhap dashurinë në rrjetet sociale"*

## PERPLASJA

**Fiori Dardha  
largohet  
nga "Dance  
With Me"**



**Reagon  
moderatorja:  
Nuk kam asgjë  
personale  
me Bertin**

PAS SHERRIT ME ROBERT ALIAJN

# Fiori Dardha largohet nga "Dance With Me"

*Reagon moderatorja: Nuk kam asgjë personale me Bertin*

**D**ebati i Fiori Dardhës me Robert Aliajn dhe largimi nga spektakli i vallëzimit "Dance With Me" ka qenë lajmi që bëri bujë në rrjetet sociale. Debati nisi për dhunën ndaj grave, duke degraduar më pas në terma shumë të rëndë.

"Të paktën më pëlqen që ju të dy kërceni bashkë, sepse të gjithë këta hanë dajak nga burrat", - tha Aliaj.

Pas këtij momenti, ka ndërhyrë ashpër Fiori Dardha.

"Bashkëshorti im nuk e çon nëpër mend të ngrejë dorën mbi mua. Mjerë gruaja jote", - i tha Fiori, Robert Aliajt.

Mehdi Malkaj-Robertit: Jep dorëheqjen.

Robert Aliaj: Ke dalë në pension ti.

Mehdi Malkaj: Është tragjike të vdesësh para pensionit, jo të dalësh në pension.

Robert Aliaj: Karagjoz.

Ndërkohë, Valbona Selimllari i ka dalë në krah dhe ka mbrojtur kolegun e saj Robertin, duke i kërkuar Fiorit që të qetësohej dhe të mos reagonte ashpër.

"Kjo është e vërtetë e dhimbshme. Meshkujt shqiptarë shumicën e rasteve janë të dhunshëm. Fiori, Bertin nuk t'u drejtua ty", - ka thënë anëtarja e jurisë. Roberti ka folur përsëri dhe i kërkoj produksionit që t'i hiqte nga dora Fiorit mikrofonin pasi i dukej si 'akullorë'.

"Çoja gruas tate në shtëpi", - iu drejtua më pas Fiori, duke i përplasar mikrofonin në tavolinë.

Valbona Selimllari: Thamë që nuk do ta kalojmë në personale... Vendos u kufij debateve.

Albi Nako: Tani më duket sikur kam ardhur te Fevziu dhe duhet të flas për baletin.

Pas disa minutash, situata u qetësua dhe Fiori Dardha u rikthye në skenë duke thënë se ndihej e ofenduar dhe nuk



pas negociatimit me produksionin, i kërkoj bashkëshortes së tij që të mos tërhiqej nga ky spektakël. Fiori u rikthye në skenë dhe performoi me sukses.

E pyetur nëse i ka kërkuar ndjesë Roberti, Fiori thotë se nuk ka ndodhur asgjë më shumë dhe asgjë më pak nga ajo që kemi parë në ekran. Ajo tregon se është e qetë, ashtu siç ka qenë dhe në momentin kur ndodhi debati. Fiori shkurt e thjesht u përgjigj se nuk ka diçka personale me Robertin dhe se tanimë vendimi që ka marrë mbrëmjen e spektaklit nuk do ndryshojë. "Unë e kam thënë atë natë, rrugëtimi im përfundoi atë natë. Nuk ka ndodhur absolutisht asgjë më tepër sa kam thënë atë natë 'live'. Unë një herë flas, nuk do ketë rikthim", - ka treguar Fiori për "Gazeta Shqiptare". Kujtojmë se Dardha është e dyta e larguar pas Linda Reit nga "Dance With Me".

mund ta vazhdonte më spektaklin.

Fiori Dardha: Rrugëtimin tim unë e mbyll këtu, dhe ju uroj shumë suksese. Falënderoj të gjithë produksionin.


Robert Aliaj: Unë përgjithësoj dhe nëse dikush e merr personale...

Gjatë ndërprerjes publicitare ka ndërhyrë bashkëshorti i Fiori Dardhës, i cili



## Vajza e ish-deputetes provokon me bikini

**V**vajza e ish-deputetes demokrate Albina Deda, Ada ka qenë shpeshherë në qendër të vëmendjes së mediave për pamjen e saj tërheqëse. Së fundmi, nga një bionde e ëmbël, Ada është kthyer në brune, ngjyrë e cila i shkon shumë dhe e tregon tepër të ëmbël. Por, përveç kësaj, ajo po tërheq vëmendjen edhe me pozat provokuese. Në llogarinë e saj në "Instagram", Ada shfaqet duke pozuar para pasqyrës e veshur me bikini të zeza ndërsa tregon trupin e linjat seksi. Prej disa kohësh Ada i është përkushtuar modelingut, ndërsa pak javë më parë ajo filloi edhe universitetin, ku do të studiojë për gazetari.







# Astronaute e së nesërmes

E ardhmja  
është emocionuese.

**Ready?**

 **vodafone**



Rrëfëhet supermodelja: Përse nuk postoj foto në rrjetet sociale si më parë

# VILDANE ZENELI:

## Ja pse njerëzit s'më besojnë që nuk kam bërë operacione plastike

Pamela Aliaj

**Ë**shtë përfolur shpesh për format e saj shumë sensuale, gjithnjë në top formë, me një trup për t'u pasur zili. Ajo është një nga modellet që përfaqëson Shqipërinë dhe Kosovën në SHBA dhe mbarë botën. Vildane Zeneli, në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" ka folur për jetën e saj

*"Nuk ka nevojë të përhap dashurinë në rrjetet sociale"*

si modele, pasionet e saj jashtë kësaj fushe kaq shumë të lakuar. Gjithashtu, Vildane ka folur edhe për fotot nudo të postuara para pak kohësh, për kritikën që mori dhe për foton ku në media u përfol se përdori fphotoshop. Ajo që ne nuk dimë është jeta e saj e lidhur me muzikën dhe projektet që pritet të sjellë. Gjithashtu ka zbuluar edhe një sekret të vogël që ka ndodhur një vit më parë, që e bëri të largohet për një farë kohe. Këto dhe të tjera, për më tepër në intervistën e mëposhtme.

**Je një nga femrat më të bukura në mbarë botën. Sa**

e kërkuar, është një ndjenjë shumë e mirë, por një vëmendje e tepërt e pakërkuar është mbytëse.

**Sa kohë i dedikon vetes?**

Të them të drejtën e adhuroj të bëj shumë palestër, shoh çfarë ha dhe gjërat që i jap trupit. Kujdesem që lëkura të duket e shëndetshme dhe bëj pastrimin e fytyrës një herë në muaj. Përdor kremra për fytyrën për ta mbajtur të hidratuar. Sigurohem që të bëj të paktën 7 orë gjumë. Ka gjithçka të bëjë me mënyrën se si ndihesh brenda vetes. Nëse ti je e lumtur, e transmeton në bukurinë tënde të jashtë-

**alizoni?**

Unë jam gjithnjë duke punuar mbi diçka, por është e vështirë të postoj gjithçka që jam duke bërë, për shkak të një problemi legal. Kam pasur një aksident në punë para një viti, theva kyçin shumë keq. Ishte sikur të prisja dorën time të djathtë. Tani jam në procesin e zgjidhjes me hotelin ku ndodhi aksidenti dhe derisa të arrihet marrëveshja e zgjidhjes nuk mund të postoj shumë nga puna ime.

**Çfarë projektësh të presin përveç modelingut, këtë sezon?**

Kam bërë modelen në vende të ndryshme, por që kur pata aksidentin, kam qenë duke punuar mbi muzikën time dhe jam duke shpresuar vërtet të përfundoj diçka herët a vonë. Unë jam një kritike ekstreme e vetes dhe dua të bëj më të mirën në atë që jam duke bërë, kjo është arsyeja përse nuk kam lançuar asgjë ende, sepse dua të jem e sigurt se kur ta lançoj diçka të jetë perfekte.

**Keni zgjedhur modelingun si pjesë kryesore të jetës suaj. A keni të tjera pasione përveç modelingut? Me çfarë merreni jashtë kamerës?**

Unë bëj edhe punë të tjera dhe kam pasione të tjera përveç modelingut; njëra është muzika ime, me të cilën jam duke punuar. Unë gjithashtu punoj në kompaninë time, ku blej shtëpi, ne i ndryshojmë ato pastaj i shesim. Është një punë part-time, por është argëtuese.

**Të shfaqurit nudo nuk është më klishe për shqiptarët. Keni marrë kritika për këtë gjë?**

Unë mendoj se, nëse është një nudo artistike, është shumë në rregull. Kjo është pjesë e të qenit modele, nuk është asgjë e re dhe është bërë shumë më e kërkuar se kurrë. Ka atletë të cilët po pozojnë nudo, artistë, aktorë, kërcimtarë, këngëtarë etj. Për aq kohë sa bëhet me shije, është shumë në rregull. Unë mora shumë kritika, edhe pse fotot e mia ishin bërë për projekte më të mëdha dhe ata



**e vështirë është të jesh gjithnjë në formë dhe e kurrar?**

Ky është një kompliment shumë i madh, të faleminderit! Unë kujdesem për veten, sigurohem që të bëj gjithçka që të jem në formën më të mirë, kujdesem që të ha siç duhet, nuk pi alkool dhe bëj palestër 2 orë, 7 ditë të javës. Është vërtet një përkushtim, por më mban shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht. Për aq kohë sa jam

**Cili është sekret i bukurisë suaj?**

Nuk kam një sekret të veçantë sesa të kujdesem me atë që ha dhe të bëj palestër. Sekretin e të qenit e bukur është lumturia. Ajo i bën njerëzit të duken më mirë.

**Njiheni për bashkëpunime të ndryshme me reperë të famshëm. Keni ndonjë projekt tani së shpejti të re-**



që i bënë janë artistë të nudos. Mendoj se jam gjykuar më tepër për shkak të seks appeal-it tim. Shumë njerëz nuk arrijnë ta shohin se këto foto nuk kanë asnjë lloj lidhjeje forme apo të krijojnë foto ofensive. Nuk kam çfarë t'i bëj pamjes sime të jashtme. Unë gjithashtu marr shumë komplimente nga ata që e kuptojnë artin dhe janë në të njëjtën industri si unë.

**A do të guxonit të pozonit për një revistë si "Playboy"?**

Jo, nuk do të pozoja asnjëherë për revistat si "Playboy". Jam një modele profesioniste, dhe "Playboy" e kalon kufirin, sipas mendimit tim, sepse, edhe pse shumë do të thoshin se janë foto të artistëve, të gjithë e dimë se ajo është një revistë për meshkuj, dhe kjo nuk është ajo që unë dua të bëj me karrierën time, nuk po përpiqem t'u bëj qejfin meshkujve. Gjithçka që unë bëj, e bëj sepse dua ta bëj, jo për t'i bërë qejfin askujt. Ky nuk është qëllimi im në jetë. Jam duke bërë vetëm detyrën time si modele. Nuk kam bërë një foto nudo për një kohë të gjatë, por çdo foto që kam bërë ka qenë artistike dhe me shije.

**Në foto belit duket shumë i ngushtë. Sa centimetra e keni në të vërtetë?**

Në fakt është 60 cm. Unë punoj shumë për muskujt e mi të barkut dhe sigurohem që beli im të jetë i vogël. Ndonjëherë e vesh edhe "waist trainer" dhe më besoni që punën e bën, por është e pashëndetshme për trupin. Jam munduar të mos e vesh shumë shpesh.

**Si ndiheni me faktin që keni bërë disa operacione plastike në trup? Jeni pen-duar? A do të bëni të tjera ndërhyrje?**

Nuk kam bërë asnjë ndërhyrje në trupin tim. Mendoj se është e vështirë për të tjerët të kuptojnë dhe ta pranojnë se unë nuk kam bërë ndërhyrje, por nëse gjithkush kujdeset për trupin në mënyrën e duhur, mund të ketë rezultate shumë të mira. Ka shumë vajza që mund t'i gjeni duke hyrë në "Instagram", ku ato tregojnë mënyrat se si të bëni ushtrime dhe se si mund të arrini formën ideale të trupit tuaj. Do të doja edhe unë të

postoja video të ushtrimeve, por do shumë punë dhe do më duhej edhe dikush që të më filmonte. Dua të përqendrohem kur bëj ushtrime dhe jo të më tërheqin vëmendjen. Mund të them se kam qenë e bekuar gjenetike, por gjithashtu bëj ushtrime, siç thashë edhe më parë, për të pasur trupin që kam. Është për të qeshur, sepse shumë persona që mendonin se unë kisha bërë ndërhyrje në trup, kur më panë 'live' janë shokuar. Është për të qeshur kur sheh reagimin e tyre: "Oh, Zot, vërtet ti je kështu, nuk ke bërë asnjë ndërhyrje në trup. Dua të di çfarë ushtrimesh bën". Unë gjithashtu di si të pozoj në foto; duke qenë se kam qenë modele për kaq shumë kohë, i di çilat janë anët e mia më të mira. Ndonjëherë gjërat duken më të gjata në foto sesa kur i sheh 'live'. Nuk e vras mendjen e as më ndikojnë kur njerëzit thonë fjalë të këqija. Unë kam vetëbesim në pamjen time dhe, për aq kohë sa unë nuk kam bërë asgjë, është gjithçka punë e lodhshme dhe dedikim, kjo ka rëndësi për mua.

**Si i keni marrëdhëniet me modellet e tjera në Amerikë, Adrolën, Xhesikën, Afërditën? Me kë i keni më të mira?**

Jam takuar me Adrolën dhe Xhesikën për një kohë të shkurtër, në partin e Krishtlindjeve të Fadil Berishës, vitin e kaluar. Nuk kam folur shumë me to, por ato janë shumë të bukura dhe u uroj një sukses në vazhdimësi. Jam mikeshë me Afërditën. Ajo është një vajzë fantastike, një shpirt i bukur dhe një vajzë shumë e bukur.

**A është dikush në jetën tuaj? Keni të dashur shqiptar apo të huaj?**

Jeta ime private mbetet e tillë. Kjo është pjesa e jetës sime që ka shumë rëndësi për mua dhe s'mendoj se është e nevojshme të përhapim dashurinë në gjithë rrjetet sociale. Gjërat speciale i mban për vete.

**Enca bëhet e 'rezikshme', ja kush i çon mesazh**

Ajo është një nga këngëtalet më të komentuar të momentit në të gjitha rrjetet sociale. Bëhet fjalë për Encën. Nëse i keni dërguar ndonjë mesazh, kini kujdes, pasi këngëtarja sapo bëri të papriturën. E irrituar nga fakti se të gjithë e pyesin pse ajo nuk u kthen përgjigje në "Snapchat", Enca ka publikuar një video ku tregon mesazhet pa fund që i vijjnë. "Kur dikush më thotë: Të shkrova në snapchat, pse nuk ma ke parë mesazhin. Ja shikojeni si duket snapchati im", thotë Enca në video.



Ndërsa, krahas videos shkruan: "Kujdes: Mund të gjeni shokun, të dashurin, babin, mamanë ose profesorin te lista e emrave".



**Adelina Ismajli çmend rrjetin, tregon format bombastike**

Që prej fillimeve të karrierës, Adelina Ismajli është konsideruar si diva e skenës shqiptare, e duket se nuk ka ndërmend ta humbasë këtë titull. Edhe pse vetëm 6 muaj më parë është bërë nënë për herë të parë, këngëtarja e njohur ka lënë pa fjalë ndjekësit në rrjetet sociale. Ajo ka publikuar një foto në "Instagram" ku shfaqet me bikini e ku bien në sy linjat e saj bombastike. "Sërisht te trupi im!" - shkruan këngëtarja, duke shpjeguar se në vetëm pak muaj, ajo u është rikthyer linjave të saj të mëparshme. Në foton e shkrepur në bordin e një jahti, Adelina duket mahnitëse me një palë bikini ngjyrë rozë, teksa po shijon pushimet e para si nënë së bashku me familjen e saj.

Opinion i Ditës

# Pse nuk ka investime të huaja në Shqipëri

Nga Arian Galdini

(Vijon nga faqja e parë)

... me fazshmin, mendova se ai njeri i ditur, nuk kishte asnjë dëshirë që t'i frymëzonte lexuesit e tij. Përkundrazi, në çka shkruante, fshihte një ngucje të ligë dekurajuese. Isha shumë i ri kur e lexova për herë të parë.

Sot, ndërsa sapo kam kaluar të 40-tat, më vjen krejt ndryshe ai tregim. Më vjen si një foto e pandryshueshme 105-vjeçare e vendit tim.

Që ditën e parë që thamë se bëmë shtet, nuk kemi reshtur së ripërsërituri se po bëjmë apo do të bëjmë shtet. Të gjithë udhëheqësit tanë, pa përjashtim, nga Ismail Qemali e deri tek Edi Rama, e kanë pasur shtetbërjen si një lajtmotiv çuditërisht mrekullibërës.

Në fund, të gjithë kanë ikur, edhe Edi Rama do të ikë, e pasardhësi menjëherë ka shpallur se ai dhe vetëm ai di e do të bëjë shtet.

Pse ky kompleks i ditës së parë të shtetbërjes, po na mban kaq të ligsh dhe të ngërthyer pas rrobës së policit e skërmitjes së taksidarit? Pse?

Pas 105 vitesh, ditë e parë e shtetbërjes, çdo ditë, 1/3 e shqiptarëve e kanë braktisur Shqipërinë, e sot sipas Barometrit Ballkanik, gjysma e atyre që kanë mbetur, duan të ikin një orë e më pas.

Si mund të vazhdohet kështu?! Si mundet që me çdo lider e parti që fiton apo mëton fitoren, neve na duhet të jetojmë çdo ditë, ditën e parë të shtetbërjes dhe të mbajmë mend se i vetmi mëngjes shtetëror që kemi parë ka qenë me mbret e xhandar dhe dreka e muzgu kanë qenë me diktator, sigurimsa dhe organizata bazë partie?!

Kjo marrëzi duhet të marrë fund, përndryshe më keq do bëhet! Sinqerisht që në këtë pikë ku jemi, nuk e di sesi mund t'i jepet fund kësaj marrëzie, por e di që po nuk e gjetëm mënyrën ta ndalim, atëherë të gjithë do të bëhemi të marrë, ose kush do të shpëtojë, do të ikë nga ky vend.

Në nuk dalim dot nga kllapia e

ditës së parë të shtetbërjes, sepse ne udhëhiqemi e jemi udhëhequr që ditën e parë, nga një shumicë dërrmuese "tregtarësh të flamujve".

Pak, shumë pak histori njerëzore dhe politike për udhëheqësit tanë, kam lexuar ku ata të mos jenë rrogëtarë të grekut, malazezit, serbit, latinut, nemesit, inglizit, francezit, turkut etj., etj., etj.

Afermendsh, rrogëtarët nuk kanë të drejtë të mendojnë.

Paguhen për të zbatuar, jo për të menduar.

Ngase kemi shumë rrogëtarë të tillë, në politikë, media, kulturë, institucione, OJF etj., etj., ne jemi një shoqëri që jetojmë sipas axhendave rrogëtituese të të gjithë mëditësve, kudo e të kujt do i kemi.

rrogëtarëve që uthin prapnica e kinde të huajsh e nuk duan t'ia dinë fare për vendin dhe gjindjen e tyre.

Këtë skemën e rrogëtarëve te të huajt, kanë filluar ta konkurrojnë në Shqipëri edhe mafia, krimi dhe partitë politike.

Të gjithë kanë hënë e tyre të rrogëtarëve.

Kush do pushtet për plaçkë dhe rrogë, nuk ka as qëllime të mbara, as dëshirë, as vizion, as ideale, as parime, e madje as mundësi për t'i shërbyer vendit, kombit, shoqërisë.

Sipas meje, kjo është edhe arsyeja bazë se përse në Shqipëri nuk ka investime të huaja.

Ne udhëhiqemi nga mediokër e batakcinj, që duan pushtet për të bërë plaçkë dhe rroga të majme për të bërë qejf.

e huaja do të jenë vetëm offshore me emërhuazues që vijnë vetëm të pastrojnë paratë e plaçkëbërësve që kemi në krye të vendit.

Ky soj janë tregtarë flamujsh që janë shpirtmbyllur për vendin dhe gojëshqyer për plaçkë e rroga të majme.

E për ta mbyllur, po them se, për shkak se kemi shumë, po shumë fare rrogëtarë të tillë, të kundodhur e të prejkujtudo paguar, në Shqipëri kemi shumë opinione, e pak mendim.

Rrogëtarët e fitojnë shpërblesën a pagesën e tyre duke na mbytur me opinione ku ne ndahemi, zihemi e grihemi, e për të na vrarë



Kjo është edhe arsyeja pse kemi kaq shumë fushata linçimesh apo lëvdimesh, të cilat na gllabërojnë të gjithëve si shoqëri reale dhe si shoqëri virtuale.

Kur ne përfshihemi në sharje a lëvdata, në gjithfarë debatesh e fushatash që ndizen këtu, ne në fakt u bëjmë një nder të madh

Asnjë vend i huaj, nuk çon investime aty ku ka udhëheqës që u paguan rrogat.

Ta ndajmë mendjen e të kthjellohem për këtë.

Për sa kohë shumica dërrmuese e udhëheqësve tanë do të jenë rrogëtarë të të huajt, mafia, krimi apo partitë, për aq kohë investimet

mendimin që as të mos shohim dot e as të mos kuptojmë dot.

A mund ta ndalim dot këtë marrëzi?

Nuk e di...

Por, sido që të jetë, nuk duhet të mbyllim gojën.

E vërteta duhet thënë, sepse ndoshta është i vetmi shpëtim.

## HOROSKOPI

### DASHI

Nën tërheqjen e Venusit dhe Marsit, Hëna ju prish disi qetësinë dhe krijon pengesa në rrugën tuaj të gjatë. Do të merreni të promovoni një projektin tuaj të punës, tek i cili keni shumë pritshmëri. Gjasat janë që të dalë me sukses.

### DEMI

Nëse me partnerin është krijuar pak tension, mos e vononi çështjen për ta sqaruar. Për të kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë sesa mendoni. Përfitimi nga mbështetja që ju garanton familja, për të përmbyshur zgjedhjet që do bëni.

### BINJAKET

Rruga e gabuar dhe vonesat mund të bëjnë që të dështojë një plan. Por mos u dekurajoni, pasi keni mundësi të gjeni zgjidhje më të mira akoma. Organizoni një udhëtim: do të bëjë që të krijoni kontakte interesante me persona të panjohur.

### GAFORJA

Për shkak të veprimrit të Hënës, dita do të jetë disi e vështirë, me shumë keqkuptime, ankesa dhe mendime jo shumë optimiste. Sot në dashuri do të jeni pak jashtë ritmit. Asgjë për t'u shqetësuar, por dëshira për t'u larguar nuk e favorizon mirëkuptimin.

### LUANI

Perfeksionizmi gëlon në venat tuaja, por do të ishte më mirë të liroheshit nga kjo, pasi ju streson dhe çon në ndikime negative në raportet profesionale. Takimi me dikë që nuk e keni parë prej shumë kohësh do të bëjë që të ndizet një flakë e vjetër pasioni.

### VIRGJERESHA

Nëse ndiheni të kushtëzuar nga kërkesat dhe gjykimet e një familjari, vërini vetes objektiv që të liroheni për të marrë vendime. Duke qenë se ju pëlqen të jeni në qendër të vëmendjes, do të zbloni se kështu do të ndiheni mirë.

### PESHORJA

Mbështetja e Mërkurit, por me armiqërinë e Venusit dhe Marsit, do të bëjë që të ndiheni faktorë në frontin e dashurisë. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë. Nuk mund t'ia lëni më rastësisë.

### AKREPI

Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Mërkuri angazhohet duke ju vënë shkopin në rrota. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rri për krahu dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

### SHIGJETARI

Për shkak të Venusit, çështje të zemrës mund të bëjnë që të lini pas dore punën. Por Saturni ju tërheq vëmendjen dhe ju shtyn të keni përqendrim dhe qartësi në mendime. Nëse e kuptoni që personat që rrinë rreth e rrotull jush nuk ju përshiaten, largohuni prej tyre.

### BRICJAPI

Të jeni më të dashur nuk ju bën veçse mirë. Pa dëshirë, do të lehtësoni ndjeshëm raportet me personin që keni në krahu. Mos harroni: Ndërrytja e një familjari në punët tuaja do t'ju nervozojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

### UJORI

Falë Jupiterit që ju mbështet, nëse keni ndonjë ide të bukur që ju shkon ndërmend, vëri në veprim. Do t'ia dini të gjeni edhe aleatë. Nëse do të këtë fërkime brenda familjes, largojuni duke e kaluar me sportivitet.

### PESHQIT

Loja e dashurisë do t'ju shtyjë të gënjeheni disi, duke shpikur ëndrra dhe iluzione, por do t'ju shërbejë për të pasur një takim edhe më të mirë. Nganjëherë përpikuni të jini më të çlirët, kur nuk i kuptoni nganjëherë gjërat nga këndvështrimi i dikujt tjetër.

**BLUE TOOTH**  
THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA

te rejat nga jeta  
**Vipave**  
çdo të shtunë falas me

Dje në Deutsche Welle

Bernd Riegert

# Copëzimi në shtete të vogla nuk është zgjidhje për BE-në


(Vijon nga faqja e parë)

... Disa rajone madje nuk kërkojnë mëvetësinë, por vetëm më shumë autonomi, ndërsa të tjerë rajone si Skocia apo Katalonja duan të bëhen shtete nacionale. Këto forca separatiste shihen në BE në Bruksel me ndjenja të dyzuara. Sepse ato venë në pikëpyetje rendin e shteteve ekzistuese nacionale, por mbrojtja e integritetit të shteteve nacionale, që janë anëtarë të BE-së, është pjesë e marrëveshjeve të BE-së.

Vetëm nëse një shtet nacional e ndryshon brenda vetes në mënyrë demokratike strukturën e vet, BE-ja nuk ka asnjë problem. Si shembull vlen të përmendet këtu bashkimi i RDGJ me RFGJ në vitin 1990 apo ndarja e Çekosllovakisë në dy shtete të pavarura në 1992. Ndonëse Çekia dhe Sllovakia janë anëtarësuar shumë më vonë pas ndarjes në BE. Edhe një shkoputje e mundshme e Skocisë nga shteti nacional Britania e Madhe, ndonëse jo e dëshiruar, është jo problematike për BE-në, sepse Britania e Madhe e kishte miratuar si e tërë referendumin skocez. Ndryshe nga Katalonja, ku shteti spanjoll e mohon të drejtën e katalonjasve për referendum.

Ka vetëm zgjidhje sipas rastit Çdo rast është i ndryshëm. Ka pasur edhe shkëputjen e Kosovës nga Serbia, por kjo është pranuar nga BE-ja, po ashtu edhe shpërbërja e Jugosllavisë si dhe e Bashkimit Sovjetik. Pjesë të këtyre ish-shteteve sot janë anëtarësuar në BE. Një njohje e shtetit të Katalonjës nga vendet e tjera anëtare të BE-së nga këndvështrimi i sotëm duket të jetë e përjashtuar. Qeveria katalonjase nuk duhet të ketë iluzione në këtë drejtim.

Por cila mund të jetë zgjidhja, një perspektivë për të ardhmen, se ç'qëndrim duhet mbajtur ndaj konflikteve mes rajoneve dhe shteteve nacionale, të cilave u



përkasin ato? A ka një përgjigje europiane? Herë pas here ka nisur me propozimin e krijimit të një "Europe të rajoneve". Si për kohëzgjatje, pikërisht këtë javë në Bruksel është mbledhur "Komisioni i Rajoneve", një forum, në të cilin marrin pjesë 350 përfaqësues të rajoneve në 28 vendet anëtare, një lloj parlamenti. Komisioni i Rajoneve është megjithatë vetëm një forum konsultues. Pushtetin legjislativ e ndajnë në BE shtetet nacionale në Këshill dhe në Parlamentin Europian të zgjedhur në mënyrë direkte. Propozimi për t'i shfuqizuar shtetet nacionale në BE dhe për t'i forcuar rajonet si Katalonja, Kerteni apo Shlesvig-Hoshtein dhe për

t'i bërë ato si kompetente të vërteta të identitetit europian është joshëse në aspektin e shtetit teorik, por në praktikë kjo është e parrealizueshme.

Nacion apo rajon? Federalizimi i shteteve nacionale të zhvilluara historikisht është i vështirë. Nuk është vetëm ndjenja rajonale e atdheut, por edhe

identiteti nacional, që nuk mund të shpërbëhen kaq thjeshtë. Gjithashtu, separatistët në Katalonjë nuk duan më të jenë vetëm një rajon në Europë, por një shtet i mirëfilltë, sepse besojnë, që katalonjasit përbëjnë një komb. Këtu shkrihen konceptet dhe përkufizimet. Çfarë është një komb, ç'është një rajon dhe ç'është një konfederatë?

Sot 28 shtetet në Bruksel dhe 750 deputetët duhet të bien dakord dhe të marrin vendime. Nëse shtetet nacionale zëvendësohen nga rajonet e përcaktuara tani në BE, atëherë nuk do të kishte më një samit të 28 shteteve nacionale, por të 98 rajoneve. Këto rajone i përgjigjen asaj që në Gjermani është landi federal, por ka edhe ndarje në njësi më të vogla. Nëse rajoni ndahet në nivelin e qeverive lokale në Gjermani, atëherë do të kishim 276 rajone. Nëse këtyre u shtojmë edhe qarqet si në Gjermani apo departamentet si në Francë, si njësi për pjesëmarrje politike në BE, arrijmë në një shifër prej 1342. Një Europë e tillë do të ishte me kompetencat e sotme që ajo ka e pamundur të qeverisej.

Këto shifra burojnë nga Autoriteti Europian i Statistikave. Këto BE-ja i ndan në rajone të pastra të nivelit të parë deri në të dytë (NUTS), sepse subvencionet e BE-së dhe ndihmat strukturore qysh sot planifikohen dhe llogariten në njësi të vogla.

Copëzimi në rajone nuk do ta zgjidhte problemin politik që shohim në Katalonjë. Sepse edhe nacionet të vetëpërcaktuara, që e ndiejnë veten në BE ashtu si një pjesë e katalonjasve të "shtypur", duhet t'u bëhet e qartë që mëvetësia shtetërore dhe shtetet e vogla në kohën tonë nuk sjellin më përparimin. Katalonjasit mund të përpiqen ta ndryshojnë Spanjën, po ashtu edhe skocezët Britaninë e Madhe. Por për këtë nuk është Europa, partneri i duhur i negociimit.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE  
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE  
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



Kreu i FSHF-së bën analizën e eliminatorëve në një takim me gazetarët. Vlerëson vendin e tretë

# Duka: Dua Europeanin dhe rikthimin e TKZ-së në stadium

## Për presidentin, Panuçi e ka kaluar "klasën"



Jeton Selimi

Në një bashkëbisedim me gazetarët pas mbylljes së eliminatorëve për Botërorin "Rusi 2018", presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka, bëri një bilanc të ekipit kombëtar, pas renditjes të tretë në grup. "Dy ndeshjet e fundit mund të mbylleshin më mirë nga pikëpamja rezultativ, por në këtë edicion përkufizimin duhet ta japin më mirë ata që mbështesin ekipin kombëtar, por në total do ta konsiderojmë një edicion pozitiv. Kemi zhvilluar 10 ndeshje, kemi arritur një vend në klasifikim, më të mirin e Shqipërisë. Pengjet janë dy ndeshje, ajo me Izraelin në shtëpi dhe sfida e fundit me Italinë, ku mund të merrnim një pikë".

Duka u shpreh i kënaqur edhe për punën e trajnerit të ri, Panuçi që sipas tij ka bërë maksimumin gjatë kësaj periudhe që ka drejtuar kuqezi. "Në të tërën gabimet nuk kanë qenë të mëdha. Ka qenë një paraqitje e mirë, ndoshta një lojë jo e mirë, por futbollit është cinik. Duhet ta shohim në lojën e dhuruar dhe rezultatet dhe në total është një punë e kënaqshme. Fatkeqësi e tij dhe e stafit të tij që kishte dy kundërshtarë shumë të fortë dhe pse ndoshta e meritonim një pikë me Italinë". Nga edicioni i ardhshëm do të fillojë dhe Liga e Kombeve, një kompeticion që jep një mundësi shtesë për kualifikimin në European dhe

Shqipëria aktualisht gjendet në vazh C. Numri 1 i FSHF mendon se Shqipëria i ka shanset për të qenë sërish prezente në European, por dhe për të qenë një vazo më lartë. "I kam hedhur një syn ndajrës së grupeve të Nation League dhe mendoj se objektivi Shqipërisë është jo grupi C, ku gjendemi, por grupi B. Në asnjë rast nuk mund të mendojmë të jetë në C. Ne kemi mundësi reale për të marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme dhe në ndonjë rast, në Botëror. Ndeshjet e fundit kanë konfirmuar se Shqipëria është ekip i fortë dhe kompetitiv".

Një çështje e nxehtë në media ka qenë dhe mungesa e afrimit të një lojtari si Lila nga Kategoria Superiore, por presidenti i FSHF-së shprehu besimin se rritja e cilësisë në Superiore do të



sjellë dhe afrimit e më shumë futbollistëve pranë Kombëtares, edhe pse këto janë çështje ekskluzive të

trajnerit. "Janë zgjedhje të trajnerit. Kemi shpesh raste kur lojtarë të nivelit të lartë,

sepe konkurenti tij është akoma më lartë, ndaj janë zgjedhje që varen nga momenti dhe pozicioni. Jo vetëm Lila, por edhe të tjerë mund të afrohen dhe në ndeshjet e nëntorit trajnerit do të provojë". Në këto eliminatorë u krijua dhe një krisje me Tifozët Kuq e Zi, duke bërë që ky grupim të mungojë në stadium në ndeshjet brenda të ekipit. Për Dukën është e rëndësishme që të gjithë të tejkalojnë problemet për një qëllim të përbashkët, mbështetjen e Kombëtares. "Problemi që kemi pasur gjatë këtij edicioni është bojkoti i Tifozave Kuq e Zi". Arsyet kryesore nuk varen

nga Federata e Futbollit dhe nuk dua të fajsojë një institucion tjetër, sepse bëjnë detyrën e tyre. Ai që dëmtohet është ekipi. Duhet të tejkalojë dhe diçka që mund të të ketë cenuar, si në rastin e Tifozave Kuq e Zi. FSHF është organizatë sportive dhe nuk siguron kontrollin apo jo të njerëzve në stadium. Mund të kesh drejtë, por qëllimi është dhe më i madh. Është e rëndësishme të mbështetur gjithmonë dhe uroj të ketë përfunduar ai bojkot dhe të fillojmë mbarë edicionin e ardhshëm".

Në fund dhe një opinion për kombëtares e u-19 që pësoi 3 humbje në 3 ndeshjet e eliminatorëve të saj, mbi të gjitha një me rezultatin e thellë 1-7 me Norvegjinë. "Prisim më shumë nga U-19, pasi rezultatet nuk ishin të mira dhe do të ketë diku nga fundi nëntorit një lojë analize e do të vihen detyrat për të ardhmen".

### Disiplina gozhdon "boksierët" Dediç dhe Miraka

Gjoka për klubet dhe pezullime për dy lojtarët protagonistë "për keq" të kësaj jave. Skënderbeu e Lushnja u dënuan me gjoba 100.000 mijë lekë, ndërsa lojtari i Teutës, Dediç dhe ai i Luftëtarit, Miraka, u dënuan me 5 ndeshje pezullim nga aktiviteti, për goditje ndaj lojtarit kundërshtar. Komisioni

i Disiplinës në FSHF zbardhi edhe vendimet për datën 13 tetor 2017. "1.KF 'Skënderbeu', për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 65/1 dhe Nenin 66/1 të KDS, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë. 2.KF 'Lushnja', për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 65/1 dhe Nenin 66/1 të

KDS, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë. 3.Lojtari i KF 'Teuta', Anel Dediç, për goditje ndaj lojtarit kundërshtar, në bazë të nenin 48/1.e të KDS, dënohet me 5 (pesë) ndeshje pezullim nga aktiviteti. 4.Lojtari i KF 'Luftëtarit', Festim Miraka, për goditje ndaj lojtarit kundërshtar, në bazë të nenin 48/1.e të KDS, dënohet me 5 (pesë) ndeshje pezullim nga aktiviteti", janë disa prej vendimeve kryesore.



### Derbi i Anglisë, Liverpool-Junajtid

#### Klop nuk i trembet shkarkimit, Murinjo: Kam 10 sulmues

Derbi i Anglisë po troket në një moment shumë të veçantë për dy trajnerët karizmatikë, Jurgen Klop dhe Zhoze Murinjo. Dy personazhe interesantë që edhe në konferencat e shtypit përpara ndeshjeve kanë përherë diçka interesante për të thënë. Këtë herë është radha e gjermanit për të rrembyer skenën me një dialog të hapur me gazetarët, ku e pranon se situata që po kalon nuk është një nga më pozitivet. "Nëse më shkarkojnë në këto momente, nuk mendoj se do të gjejnjë një menaxher për të bërë një punë më të mirë se ajo që po bëj unë tani. Nuk mendoj se jam perfekt, por është e vështirë të gesh alternativa më të mira. Unë vazhdoj të mendoj si 98% e mbështetësve të Liverpoolit sipas të cilëve jemi në rrugën e duhur. Kjo është një punë fantastike, por edhe shumë e vështirë dhe unë kam shijuar çdo sekondë. A jemi në pozitë që dëshirojmë? Sigurisht që jo! Kemi arritur rezultate më të mira sezonin e shkuar, prandaj duhet të përmirësojmë situatën edhe pse nuk kemi një diferencë të madhe me skuadrat e kësaj. Jam në mesin e një rruge të gjatë dhe jam gjithashtu shumë i qetë", tha Klop. I veçantë në llojin e tij, edhe Zhoze Murinjo. "Special One" e justifikon nofkën e tij edhe këtë herë. "Unë luaj me një mbrojtës dhe 9 sulmues, mos u habisni aspak për këtë që po them. Tani që luajmë me një sulmues të deklaruar jemi përshtatur me një sistem të ri. Nuk duhet të fshihemi pas gishtit, por kompani ka ekipë më të mira se ne, por kjo do të vërtetohet në fund të sezonit kur të shpallet kampioni, nënkampioni e kështu me radhë. Të gjithë pretendentët dëshirojnë vendin e parë, prandaj nuk ka ndeshje të lehta dhe të vështira. Sezonin e shkuar lamë pikë në shumë ndeshje sepse në tunel ndihesh i sigurt me fanellën që vesh, por në humbëm shumë pikë në fushën e lojës. Edhe këtë sezon lamë pikë kundër Stoke City, por rikuperuam në ndeshje të tjera".

### TRAJNERI I ATLETIKOS

#### Simeone: Mesi tregoi se është lojtari më i mirë në botë

Diego Simeone dhe Leo Mesi janë dy prej person aliteve më të famshëm në Argjentinë. Edhe pse trajneri i Atletikos dhe ylli i Barcelonës nuk kanë një marrëdhënie të madhe jashtë fushës së lojës, ata kanë respekt të përbashkët për njëri-tjetrin. Tekniku 47-vjeçar foli këtë të premtë, pas ndeshjes së Argjentinës, edhe për faktin që tre golat e Mesit e çuan vendin e tij në Rusi. "Qëndrova zgjuar dhe e pashë ndeshjen. Mesi ishte në natën që të gjithë argjentinasit do të kërkonin të ishte. Pavarësisht se Ekuadori shënoi i pari, Mesi me golat e tij, i tregoi atyre që nuk kishin besim tek ai, se është lojtari më i mirë në botë", - deklaroi Diego Simeone.




### PROBLEME ME DËGJIMIN

#### Lajpcingu nuk grumbullon Vernerin, në Dortmund ka shumë zhurmë

Timo Verner nuk është grumbulluar me skuadrën e Lajpcigut, për transfertën e Dortmundit këtë fundjavë. Arsyja mund të duket qesharake, por në fakt është e vërtetë. Gazeta gjermane "Bild" shpjegon se sulmuesi gjerman do të mungojë prej "Murit të Verdhe", siç njihet ndryshe edhe pjesa më e nxehtë e tifozëve të Borussia-s së Dortmundit. Ata cilësohen si shumë të zhurmsëm dhe sulmuesi 21-vjeçar vuan sa herë ka zhurma të tilla gjatë ndeshjes. Edhe me Beshiktashin në Ligën e Kampioneve, sulmuesi u hodh titullar në fushë, por u zëvendësua vetëm pas 30 minutash lojë, pasi i cilësoi tifozët e Beshiktashit si shumë të zhurmsëm. Ai tha se ajo ishte arena më e zhurmsme ku kishte luajtur ndonjëherë. Një situatë e çuditshme kjo për Verner, që tashmë po kërkon një zgjidhje nga mjekët.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë trotuarat.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Tuhahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkordran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Entë Operative Tiranë
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.

9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe te Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishite babai i Akillit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Vriten nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.

39. Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
41. Kalimi në ekstreme.
42. Eshhtë e re pas Krishtit.
43. Shkruhet për të mos vazhduar më.
44. Si i gjithë .
47. Kush e thotë lutet.
48. Kufij elementi.
49. Ishite nyja që preu Aleksandri i Madh.
50. Një pjesë e titanëve.
51. Mund të jetë kundërmuese.
52. Pak titanike.

**VERTIKAL**

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
7. Në hyrje të oazit.
8. Arte pa re.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë ngjinja.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Entë Ekonomike Sarandë.

35. Mbyllin një ditat.
36. Satelit i Jupiterit
37. I ka tek Luani.
38. Boldi komik italian.
42. Eshhtë kolana në filma
43. Kush e thotë lutet.
44. Oxa këngëtare.
46. Inicialet e Nolte aktor.
47. Eshhtë tokë që... fitohet.
48. Një... gjermane.


**VERTIKAL**

1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Në hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve




8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicialet e Dalí, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë trysni
24. Në hyrje të Europës.
25. Janë rrobat për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktor.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelilit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Inicialet e Nolte-s.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

**SUDOKU**

4					8			
	3	8			9			2
	7			1			4	
			3			9	5	
7								6
	5	2			4			
	6			7			1	
1			6			4	9	
			1					3

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	9	7	8	2	6	5	4	3
3	8	4	5	1	9	7	2	6
6	2	5	4	3	7	1	8	9
2	3	1	7	6	8	4	9	5
7	4	6	2	9	5	8	3	1
9	5	8	3	4	1	2	6	7
5	6	9	1	8	2	3	7	4
4	1	2	9	7	3	6	5	8
8	7	3	6	5	4	9	1	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- Nuk kërkoj kompensim rilindjen në Qiell, por kërkoj të mirën e njerëzve, kërkoj të ridrejtoj ata që kanë humbur dritën e tyre, ata që jetojnë në errësirë dhe të zhduk nga bota të gjitha dhimbjet e vuajtit.
- Ai që vesh rrobën e verdhë pa pastruar, pa fituar dominimin e vetes e pa kërkuar të vërtetën, është i padenjë për ta veshur atë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
		3	5	8	2	3	5	6	1	7	5	
12	5	13	5	10	1	7		6		13		
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	
8	2	6	2		2	1	8	5	11	1		
1	6	8		17	9	5	7	2		9		
3	1	5		8	2	16			2	7	1	
2				3	2	6	5	9	2		13	
6	2	7	2			3		7	18	3	6	7
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2		

M	I	K	E		K	M		S		E	
E	K	A			R	O	M	A	K	E	T
K		M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
M	A	T	E	M	A	T	I	K	A		
P	A	S	A	N	I	K		T		S	
E	K	U		A	N	E	T	A	R	E	T
R	E	T	E		E	I	R	A	N	I	
I	T	R		B	L	A	K	E		L	
M	I	A		R	E	D		K	E	K	I
E				M	E	T	A	L	E	I	S
T	E	K	E			M		K	U	M	T
M	O	R	A	V	I	A		M	A	E	

*Thënie të mençura*

- Prej njëqind sëmundejeve, pesëdhjetë shkaktohen nga gabimet tona e pesëdhjetë të tjera nga mosdija jonë.
- Irlandeze: Ji i lumtur me çfarë ke, do të shohësh se ke përse të jesh i lumtur.
- Vdekja e pyet Jetën: Pse ty të duan kaç shumë dhe me çmenduri, ndërsa mua më urrejnë? Jeta: Sepse une jam një gjenjeshër e bukur, ndërsa ti je një realitet i hidhur.
- Të jesh me karakter do të thotë, të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njëri.



E ardhmja është  
emocionuese.  
**Ready?**



vodafone